in terms of contemporary strategies aimed at eliminating the impact of transpiration on the environment and on people's health, it is crucial to acknowledge that technology alone will not be sufficient to achieve a sustainable transport system in the future. Sustainable transport also requires changes in behavior, which can be encouraged through various land use, regulatory, pricing, education and awareness mechanisms.

## Bibliography

- Appleyard, D., Gerson, M. S. & Lintell, M., 1981. *Livable Streets*. London: University of California Press Ltd..
- Banister, D., 2011. Norman Foster: Symposium on the Future of Cities - Discussion and Concluding Remarks [Interview] (2 February 2011).
- Brown, L. R., 2009. *Plan B 4.0. Mobilizing to Save Civilization*. First ed. New York, London: W.W. Norton & Company.
- Christi, C. M. & Amekudzi, A., 2005. *Addressing Sustainability in Transportation Systems: Definitions, Indicators, and Metrics*. *JOURNAL OF INFRASTRUCTURE SYSTEMS*, March, pp. 31-50.
- Ciorra, pp., ed., 2013. *Energy. Oil and Post-Oil Architecture and Grids*. Milano: Electa.
- Ciorra, pp., 2013. *Fueling Architecture*. In: pp. Ciorra, ed. *Energy. Oil and Post-Oil Architecture and Grids*. Milano: Electa, pp. 76-83.
- Douglas, S., 2008. *Pneumatic Networks*. [Online]
- Available at: <http://www.douglas-self.com/MUSEUM/COMMS/pneumess/pneumess.htm>
- [Accessed 6 march 2016].
- Fernandez PER, A. & MOZAS, J., 2010. *Domesticating the Street (HABITAR Research Group)*. A+T - Strategy PUBLIC. *Landscape Urbanism Strategies*, pp. 35-36.
- Gehl, J., 1991. *Vita in Città. Spazio Urbano e Relazioni Sociali*. Maggioli a cura di Rimini: s.n.

- Gehl, J., 2010. *Cities for People*. Washington: Island Press.
- Ibelings, H., 2013. *Below Architecture's Waterline*. In: pp. CIORRA, ed. *Energy. Oil and Post-Oil Architecture and Grids*. Milano: Electa, pp. 114-119.
- Jacobs, J., 1961. *The Life and Death of Great American Cities*. New York: Vintage Books.
- Jakob, M., 2009. *Il paesaggio*. Bologna: Il Mulino.
- La Rocca, R. A., 2010. *Soft Mobility and Urban Transforamtion. Some Eruopean Case Studies*. TeMaLab. *Journal of Mobildity, Land Use and Environment*, March, Volume 3, pp. 85-90.
- Lanzavecchia, G., 1999. *La Citta' Futuribile*. In: *La Citta' dell'Utopia. Dalla Citta' Ideale alle Citta' del Terzo Millennio*. Milan: Libri Scheiwiller, pp. 219-246.
- Latouche, S., 2009. *Farewell to Growth*. Cambridge: polity press.
- Litman, T., 2003. *Measuring Transportation: Traffic, Mobility and Accessibility*. *ITE Journal*, October, 73(10), pp. 28-32.
- lord\_k, 2010. *DIESELPUNKS*. [Online]
- Available at: <http://www.dieselpunks.org/profiles/blogs/pneumatic-mail-part-1>
- [Accessed 6 March 2016].
- Melia, S., 2012. *Filtered and Unfiltered Permeability – The European and Anglo-Saxon Approaches*. Project. *Journal of the Deparment of Planning and Architecture*, 4(2012), pp. 6-9.
- Melia, S., n.d. *On the Road to Sustainability. Transport and Car free Living in Freiburg*. Bristol: Faculty of the built environment. University of the West England.
- Palumbo, M., 2013. *Oil and post-oil*. [Online]
- Available at: [http://www.domusweb.it/content/domusweb/en/architecture/2013/04/24/\\_oil\\_and\\_post-oil.html](http://www.domusweb.it/content/domusweb/en/architecture/2013/04/24/_oil_and_post-oil.html)
- [Accessed 28 March 2016].
- Richardson, B., 1999. *Towards a policy on a sustainable transportation system*. *Transportation Research Record*, 1670(Transportation and Environment), pp. 27-34.
- Romano, M., 1999. *Ascesa e Declino della Citta' Moderna*. In: M. MUSCOGIURI & M. SCHUBERT, a cura di *La Citta' dell'Utopia. Dalla Citta' Ideale alle Citta' del Terzo Millennio*. Milan: Libri Scheiwiller, pp. 149-210.
- Thackara, J., 2009. *Sustainable mobility #1: think more, move less*. [Online]
- Available at: <http://www.domusweb.it/en/architecture/2009/08/31/sustainable-mobility-1-think-more-move-less.html>
- [Accessed 1 March 2016].
- Wright, F. L., 1932. *The Disappearing City*. New York: William Farquhar Payson.

## Websites

- ROPEANMOBILITYWEEK. Do the right mix, European Commission's Sustainable Urban Mobility campaign, launched in July 2012, available online from: <http://www.mobilityweek.eu/> [Accessed: March 2016].
- Eltis, Urban mobility portal, available online from: [www.eltis.org](http://www.eltis.org) [Accessed: March 2016].
- Sustrans, charity organization, available online from: <http://www.sustrans.org.uk/> [Accessed: March 2016].
- Melia, Steve. University of the West England Bristol; <http://www.stevemelia.co.uk/articles.html>, <http://people.uwe.ac.uk/Pages/person.aspx?accountname=campus\sj-melia>



## TRANSPORTI HEKURUDHOR DHE MJEDISI

MSc. Fitim Shala

Pedagog në Fakultetin e Inxhinierise Mekanike

Universiteti i Prishtinës, Kosove

### Abstrakt:

Hekurudha e Kosovës, me më shumë se 300km të linjave të saj, me binarë të njëfishtë, dhe pothajse e pa elektrifikuar është shumë e amortizuar dhe funksionon me një teknologji të viteve 1965 dhe rinovuar pjesërisht më 1985. Mungesa e investimeve, e mirëmbajtjes dhe e riparimeve ka bërë që ajo të jetë tashmë e vjetëruar. Nga ana tjetër bombardimet e luftës më 1998 e kanë dëmtuar akoma më shumë. Në këto kushte ka dalë problemi i modernizimit të rrjetit hekurudhor të Kosovës dhe përafrimit të tij me kushtet Evropiane. Ky modernizim është domosdoshmëri e kohës për arsye të rolit që ajo ka në Korridorin 10, për sigurimin e një zhvillimi e bashkëpunimi rajonal në një shkallë më të lartë dhe për zhvillimin e bërthames multi-modale të rrjetit hekurudhor të Europës Jugë Lindore SEETO. Ndër infrastrukturat e transportit, transporti hekurudhor është më efikas për arsye të leverdisë ekonomike, lidhjes me vendet fqinje e rrjetet rajonale, dhe të mbrojtjes së mjedisit pasi është transporti që shkakton minimumin e ndotjes. Pikërisht për pikëne fundit, më të mbrojtjes së mjedisit, kemi ndër marrë një studim e kërkim për hekurudhat e Kosovës, të cilin po e paraqesim shkurtimisht në këtë punim.

### Hyrje

Burimet e ndotjes janë të shumta në Kosovë. Ato mund të klasifikohen në burime të ndotjes së ajrit, zhurmat, ndotje vizuale nga industritë, nga mbetjet urbane etj. Ndotja e ajrit ndodh pas shkarkimit të emisioneve ndotëse në sasi të ndryshme. Emisionet ndotëse mund të dëmtojnë shëndetin e njerëzve, kafshëve, bimët ose mund të shkaktojnë dëme materiale. Emisionet ndotëse mund të jenë të gaztë, të ngurtë ose në formën e grimcave të cilat shpërndahen në ajër. Efektet në mjedis nga ndotësi të shkarkuar në ajër mund të jenë në shumë drejtime dhe me dëme të pallogaritshme për botën e gjallë dhe mjedisin. Ndotja atmosferike ka treguar se ka efekte negative edhe tek ekosistemet dhe strukturat e tjera. Ndotësi kur është në sasi të vogël mund të mos ketë ndonjë ndikim të madh negativ, mirëpo në vendet urbane dhe në zonat industriale ky faktor bëhet shumë i rrezikshëm pasi dëmton në mënyrë të dukshme shëndetin e njerëzve. Meqenëse ndotësi e ajrit nuk njohin kufij, përveç ndotjes lokale kemi dhe ndotës rajonal dhe

global. Si shqetësim më i madh për ndotjen atmosferike janë: komponimet organike të avullueshme (VOC), CO<sub>2</sub>, NO<sub>x</sub>, CO, komponimet e sulfurit PM<sub>10</sub>, PM<sub>5</sub>, PM<sub>2</sub> etj.

Ndotësit e ajrit mund të jenë primarë, kur ata emetohen direkt nga burimet si: termocentralet, industritë, automjetet motorike etj dhe mund të jenë sekondarë, kur krijohen si rezultat i reaksioneve kimike. Në Kosovë cilësia e ajrit është e dëmtuar në zonat e zhvilluara urbane, veçanërisht në zonat industriale. Kështu ndotësit më të mëdhenj janë: KEK<sup>1</sup>, TCA, TCB, Feronikeli, Sharcemi, impiantet e ndryshëm me kapacitete të vogla dhe atyre për ngrohje. Problem mjaft shqetësues është mostrajtimi i duhur i mbetjeve industriale dhe atyre urbane, të cilat janë një faktor i rëndësishëm i ndotjes së mjedisit. Burimet potenciale të ndotjes së ajrit konsiderohen: Termocentralet (Kosova A dhe Kosova B). Gërmimet sipërfaqësore të linjtit në Obliq, kompleksi industrial në Mitrovicë, industria e përpunimit të metaleve, jometaleve dhe kimike, fabrika e çimentos

1. IKMN (2011-2014) Raporte Dokumenta për zonat e Mbrojtura

në Han të Elezit, industria e materialeve të ndërtimit, letrës, lëkurë-këpucëve, sistemet për ngrohje qendrore<sup>2</sup> (Prishtinë, Gjakovë, Mitrovicë), prodhimi i bazës së asfaltit, transporti rrugor dhe automobilistik etj. Në vijim në do të merremi me studimin e ndikimit në mjedis të rrjetit hekurudhor të Kosovës dhe me masat mbrojtëse.

### **Ndikimi i transportit hekurudhor në mjedis**

Nga të gjithë llojet e transporteve, transporti hekurudhor është ekologjikisht më i pranueshëm, sidomos për transporte të distancave e periudhave të gjata si të mallrave ashtu dhe të udhëtarëve. Prandaj politika<sup>3</sup> për hekurudhën e Kosovës synon ta zhvillojë sa më shumë atë dhe ta përafrojë me kushtet e Evropës, me qëllim zhvillimin ekonomik të vendit dhe mbrojtjen e mjedisit.

- Mbrojtja e mjedisit në hekurudhat e Kosovës përfshin aktet normative dhe aktivitetet vijuese :
- Përcaktimi i akteve dhe normave në fushën e mbrojtjes së mjedisit dhe përshtatshmëria me ligjet në fuqi;

- Vëzhgimi, shfrytëzimi dhe përdorimi i rregullave në hekurudhë;
- Përcaktimi i kushteve teknike e teknologjike të projekteve për ristrukturimin e mjeteve ekzistues dhe mjeteve të reja në hekurudhat e Kosovës, në kuadër të ngritjes së shkallës së mbrojtjes të mjedisit;
- Përmirësimi i kushteve për procedurat e mbeturinave nga proceset teknologjike dhe punimi i elaboratit dhe studimit mbi mbrojtjen e mjedisit;
- Përcaktimi i sistemit të cilësisë për fushën e ndotjes së mjedisit në hekurudhat e Kosovës (sipas normave ISO).

### **Qëllimi i mbrojtjes së mjedisit në hekurudhat e Kosovës.**

Qëllimi i mbrojtjes së hapësirës dhe mjedisit vlerësohet njëllë me synimet e zhvillimeve të tjera teknologjike në infrastrukturën e transportit ( hekurudhor dhe automobilistik). Ky qëllim mund të arrihet nëpërmjet:

- Përmirësimi të cilësisë së shërbimeve transportuese. Kjo do të thotë

2. IKMN (2005) Studimi i arsyeshmërisë për shpalljen e zonave të mbrojtura në territorin e Komunës së Prishtinës  
 3. IKMN ( 2013) Strategjia e Kosovës për mjedisin



Fig.1 Trendi i shfrytëzimit të transportit hekurudhor 2005-2013 (burimi: Agjencia për mbrojtjen e mjedisit të Kosovës, Raport për Gjendjen e Ajrit në Kosovë 2013-201)



që ndotësit e mjedisit (që janë të pranishëm apo potencial i mundshëm) t'i zvogëlojmë sa më shumë. Kjo mund të arrihet me pastrimin e ujërave të ndotura, me sigurimin e vendosjes së materialeve të rrezikshme e të dëmshme në vendet e përshtatshme etj;

- Mbrojtjes nga zhurmat dhe mbrojtjes vizuale (stacione të rrënuara ose të shkatërruara)
- Zvogëlimit të përdorimit të ujit të pijshëm, që mund të arrihet me anën e përdorimit racional të resurseve ujore, si dhe përmirësimit të rrjetit të ujësjellësit që furnizon hekurudhën.
- Zvogëlimit të përdorimit të energjisë dhe të lëndëve djegëse në çdo kohë ,veçanërisht për tërheqjen e lokomotivave.
- Përdorimit të transportit hekurudhor jo vetëm për shkak të rritjes së kapaciteteve të transportit të udhëtarëve dhe të mallrave, por edhe për shkak të përparësive konkurruese që ka ky lloj transporti në trafik dhe në siguri.
- Riedukimit të të punësuarve në këtë sektor dhe veçanërisht atyre që janë përgjegjës për ruajtjen e mjedisit dhe mbikqyrjen e rregullave të punës.

## 2.Përparësitë e transportit hekurudhor

Përparësitë e rrjetit hekurudhor janë disa.. Nga studimi ynë, kemi nxjerrë disa prej tyre që po i parashtrojmë në vijim.

### 2.1.Rritja e shfrytëzimit të transportit hekurudhor

Nga studimi ynë rezulton se pas vitit 2004 ,ku u bënë disa riparime të rrjetit ekzistues, filloi të shfrytëzohej si mjet transporti ndërrurban edhe treni. Kosova ka 333 km rrjet hekurudhor. Që nga viti 2005 e deri në vitin 2013 ka patur një rritje të numrit të udhëtarëve që shfrytëzonin trenin për udhëtim, gjë që shihet nga grafiku në figurën e dhënë.Sikurse shihet, në vitin 2010 kemi një rritje të shfrytëzimit të hekurudhës me rreth 1,2 herë më shumë se në 2005, ose 120%. Më pas, pra nga 2010 deri në 2013 ky trend është pothuajse konstant. Ndërkaq nga 2013 në 2015 shfrytëzimi i transportit hekurudhor është rritur me rreth 5% të tjera (në krahasim me 2013), megjithë problemet që paraqet në shfrytëzim, në siguri, dhe në konfort rrjeti ekzistues.

## 2.2 Problemet e shpejtësisë dhe të zhurmave në rrjetin hekurudhor të Kosovës

Skurse thamë më sipër, hekurudhat e Kosovës operojnë me më shumë se 300 km të linjave me binarë të njëfishtë e të paelektrifikuara. Edhe pse gjeometria e shumë pjesëve të rrjetit do të lejonte shpejtësinë 160 km/h, kufizimi i shpejtësisë maksimale është 70 km/h. Pajisjet e sinjalizimit dhe të telekomunikimit janë të vjetra ose mungojnë fare. Tashmë sinjalizimi është duke u modernizuar, dhe kalimet (ndërprerjet) hekurudhë-rrugë janë pajisur me barriera automatike, apo dhe janë zëvendësuar me mbikalime. Rritja e shpejtësisë së lëvizjes së trenave (me modernizimin që do ti bëhet rrjetit hekurudhor), do të shkaktojë ndotje akustike (Fig. 2). Ndërkaq mund të merren masa të atilla që këto zhurma të mos ndikojnë në qendrat e banuara që ndodhen pranë linjës hekurudhore (Fig. 3) dhe (Fig. 4). Nga matjet e kryera nga




Fig. 2 Hekurudha dhe Zhurma




Fig. 3 Mbrojtje akustike me anë barrierash artificiale




Fig. 4 Mbrojtje akustike me anë të ndërtimit të shpateve të gjelbërta

autori në bashkëpunim me Organizatën Ndërkombëtare të Hekurudhave rezulton se mjetet e ndryshme të transportit prodhojnë zhurma të ndryshme (tabela1) Nga kjo tabelë vëmë re se trenat e shpejtë ( të udhëtarëve dhe të mallrave), dhe ato me qarkullim në qytet, prodhojnë 1,6 herë më pak zhurmë sesa kamionat, 1 25 herë më pak sesa veturat dhe 1,4 herë më pak zhurmë sesa motocikletat. Nga ana tjetër zhurma e transportit rrugor është shumë kaotike dhe pa asnjë rregull, ndërsa zhurma e transportit hekurudhor është pothuajse gjithmonë konstante dhe e një karakteri tjetër. Kështu ajo nuk shkakton shqetësime tek kafshët (Fig. 5), tek bimët (Fig. 6) , sikurse shkakton rruga (Fig. 7).

## 2.3 Ndikimi i rrjetit hekurudhor në ndotjen atmosferike

Për të dalluar faktin që transporti hekurudhor është shumë ekologjik, në e kemi krahasuar ndotjen atmosferike që shkakton ai në krahasim me llojet e tjera të transportit. Në vijim po japim rezultatet e studimit tonë për ndotjen që shkaktojnë llojet e ndryshme të transportit ( tabela2), nga ku rezulton se transporti hekurudhor është më i pranueshmi, sepse ndot më pak atmosferën.




Fig 5 Kalimi i trenit dhe mos shqetësimi i kafshëve



Fig 6 Hekurudha dhe bimësia



Fig 7 Rruga dhe problemet që shkakton



# TRANSPORTI HEKURUDHOR

Tabela 1 Përqindja e zhurmës që shkaktojnë mjetet qarkulluese

Burimi i zhurmës	Forca e zhurmës në DB.
Automjetet e vogla (700 -1200 cm <sup>3</sup> )	82
Motoçikletat	90
Kamionët e rende transportues	103
Aeroplanët	150
Trenat e shpejte të udhëtarëve	65
Trena transportues shpejtësi 120 km/h	60
Treni për qarkullim në qytet	70

Burimi: *Casopis-gradjevinar.hr/.../JCE-55-2003-01-07, Zagreb-Croatia*

Tabela 2 Paraqitja e ndotjes së ajrit sipas llojeve të transportit

	Transporti Rrugor	Transporti Ajror	Transporti Hekurudhor	Transporti Detar
Përafërsisht përdorimi i derivateve (u 10 <sup>6</sup> tona)	437,11	65,60	34,97	60,24
Përqindja (%)	71,70	10,70	5,70	9,90

Burimi: *Promet i ekologija. Ekološke prednosti željezničkog prometa, 31.1.2013.*

Tabela 3 Konsumimi i energjisë në disa degë të transportit

Komponentët dëmtues	Transporti Hekurudhor	Transporti Rrugor	Transporti Ajror	Transporti Detar
Dioksid karboni	1	98	0,3	0,2
Dioksid azotuar	4	90,5	0,5	5
Hidrokarbur	1	95	1	3
Monoksid karboni	4	80	11	5
Dioksidi i squfurit	10	74	2	14
Grimcat	5	85	3	7

Burimi: *Casopis-gradjevinar.hr/.../JCE-55-2003-01-07, Zagreb-Croatia*

Tabela 4 Krahasimi i gjendjes së sigurisë në transportin tokësor në Kosovë

Lëndime në aksidente	Transporti hekurudhor	Transporti rrugor
Numri i personave të vdekur	17	614
Numri i personave të lënduar	19	18.825
Numri i personave të lënduar rende	19	4.308

Burimi: *Road Safety Strategy and Action Plan for Kosovo, An EU fonder by Europëen Union in Kosovo*

## 2.4 Transporti hekurudhor shumë ekonomik

Në transportin hekurudhor të udhëtarëve dhe të mallrave kemi një harxhim energjie shumë më të vogël sesa në llojet e tjera të transporteve. Kështu ai rezulton transporti më efikas dhe më ekonomik. Nga tabela 3 ku jepet përdorimi i derivateve të naftës në llojet e ndryshme të transporteve, del shumë qartë ky përfundim, (tabela 3). Gjithashtu nga studimi rezulton se konsumi i energjisë tërheqëse sipas njësisë punuese në transportin hekurudhor të udhëtarëve, është 3,5 herë më e ulët sesa në transportin rrugor, kurse në transportin e mallrave është 8,7 herë më e ulët.

## 2.5 Hekurudha, hapësira dhe mjedisi

Kërkesa për hapësirë toke për person të transportuar me hekurudhë është 9,5 herë më e vogël sesa në transportin rrugor. Hekurudha me dy binarë (dy-vijëshe), për një orë qarkullim ka mundësi të barti (transportojë) numër të njëjtë udhëtarësh sa të një autostrade me 16 kors, pra me një gjerësi prej 122 m. Kjo do të thotë që hekurudha e ruan dhe e mbron fondin e tokës, që është një nga pasuritë e mëdha natyrore që ka Kosova.

## 2.6 Transporti hekurudhor dhe siguria

Teknologjia e transportit hekurudhor mundëson arritjen e shpejtësisë së lartë me një shkallë të lartë sigurie. Numri i personave të vdekur dhe të lënduar në transportin hekurudhor është shumë më i ulët se në transportin rrugor. Siguria qarkulluese në transportin hekurudhor është 24 herë më e lartë në krahasim me sigurinë e qarkullimit me autovetura, dhe 2,5 herë më e lartë sesa në qarkullimin me

autobus. Sipas shënimeve të Organizatës Ndërkombëtare të Hekurudhave, siguria në transportin hekurudhor për çdo vit përgrihet falë teknologjive të reja që zbatohen në këtë lloj transporti. Për të vërtetuar këtë fakt janë bërë vërtetime për aksidentet e ndodhura gjatë vitit 2006 (tabela 4).

Edhe në drejtimin e sigurisë, transporti hekurudhor ka përparësi të padiskutueshme. Nga regjistrimet e aksidenteve të vitit 2006 rezulton: 38 herë më pak të vdekur në transportin hekurudhor sesa në atë rrugor, gati 100 herë më pak të plagosur lehtë dhe gati 225 herë më pak të plagosur rëndë. Pra ky transport është shumë i sigurt kur ka sinjalisikën e telekomunikimin e duhur, kur ka ndërprerjet me rrugën të sakta dhe personelin që shërben në hekurudhë të kualifikuar.

## Përfundime

- Transporti hekurudhor është më i sigurtë në krahasim me atë rrugor. Në të ka më pak aksidente dhe në të vlen të orientohet një numër gjithnjë në rritje i udhëtarëve dhe i transportit të mallrave.
- Hekurudha e shkarkon rrugën nga trafiku dhe siguron një transport shumë ekonomik.
- Transporti hekurudhor është shumë ekologjik, kursen fondin e tokës, ndot më pak atmosferën, shkakton më pak ndotje akustike dhe është më miqësor me mjedisin
- Transporti hekurudhor respekton njeriun dhe natyrën. Përparësitë ekologjike konkurrese të hekurudhës janë përparësitë e ekonomisë së tregut

## Literatura

- IKMN (2011-2014) Raporte, dokumente dhe aktvendime për zonat e mbrojtura
- IKMN (2005) Studimi i arsyeshmërisë për shpalljen e zonave të mbrojtura në territorin e Komunës së Prishtinës
- IKMN (2013) Strategjia e Kosovës për mjedisin
- Shoqata e Ekologëve të Kosovës (2002) Biodiversiteti i Gërmisë, vlerat dhe rreziqet që e kërcënojnë
- Ligji për Mbrojtjen dhe zhvillimin e vlerave natyrore dhe të vlerave të krijuara me punë të ambientit e të njeriut (GZK 39/88)
- Ligji për Taksën rrugore dhe ekologjike të automjeteve
- Ligji për Mbrojtjen nga zhurmat r. 02/L-102



# ZHVILLIMI I VENDBANIMEVE LINEARE DHE POLARE NË SHQIPËRI 1990-2015

Dr. Arch. L Lazar Kumaraku

Fakulteti i Arkitekturës dhe Dizajnit, Universiteti POLIS

Artikulli u recensua nga Dr. Arch. Vera Bushati

## Abstrakt:

Shkrimi i mëposhtëm lind si reflektim mbi gjendjen e vendbanimeve në Shqipëri. Me vendbanime nënkuptohen si ato urbane ashtu edhe ato rurale. Analiza e kryer do të përqendrohet në raportin që kanë këto vendbanime me sistemin e infrastrukturës së transporteve dhe të shpërndarjes. Shkrimi heton mbi raportin që ka rruga interurbane me qendrat e banuara. Qëllimi i shkrimit është të hedhë dritë mbi mënyrat se si janë ndërtuar zonat urbane apo rurale dhe se si po projektohen ato të rejtat. Në këtë shkrim për të thjeshtuar procesin e analizën, vendbanimet janë ndarë në dy kategori: lineare dhe pikësore. Mbi bazën e hetimeve paraprake është ngritur hipoteza se mënyra e të ndërtuarit të qyteteve në vendin tone është ndikuar nga mënyra e të menduarit të qytetit sipas "traditës" së konsolidimit në kohë, në rastin e vendbanimeve polar dhe atje ku ka pasur një zhvillim të pakontrolluar të mbizotëruar nga informaliteti, vendbanimi ka marrë trajtën e një vendbanimi linear.



Fig. 1 Skemë diadram e qytetit Vallo di Diano i përbërë nga bashkimi i nëntëmbëdhjetë vendbanimeve në një qytet të vetëm. Këtu aksi (rruga) kryen rolin e lidhësit midis vendbanimeve. (Paolo Portoghesi, *il progetto della città Vallo di Diano: una città policentrica dall'unificazione di diciannove comuni*, Kappa, Roma 1981.)

## Hyrje – Aksi (rruga) si lidhës, shpërndarës dhe si vektor

Në raportin midis vendbanimeve dhe aksit ky i fundit manifestohet në tre forma të ndryshme. Forma e parë e sheh aksin si lidhës midis dy apo më shumë polesh (vendbanimesh). Përdorimi i tij mund të konceptohet në shkallë të madhe kombëtare kur lidh vendbanime të ndryshme, por edhe në shkallë të vogël, atë rajonale, siç është rasti i qytetit “Vallo di Diano” (Fig. 1) të menduar dhe propozuar nga arkitekti i italian Paolo Portoghesi<sup>1</sup>. Qyteti i “Vallo di Diano” lindi si ide për të ndërtuar një rrjetë ndërlidhëse në një zonë me identitet lokal shumë të fortë siç është ajo e luginës që ndodhet në rajonin Campania-s në Itali. Në këtë rast Paolo Portoghesi me përjashtim të rrjetit infrastrukturor rrugor, projektonte edhe qendrat e çdo vendbanimi. Këtu roli i aksit (rrugës) paraqitet thjesht si një lidhëse midis vendbanimeve të ndryshme.

Forma e dytë e paraqitjes së aksit prek sferen funksionale të tij dhe e shpreh atë si shpërndarës në brendësi të një vendbanimi. Shembull është rasti i qytetit linear ku të gjitha rrugët kanë një rol shpërndarës në brendësi të vendbanimit.

Forma e tretë e shprehjes së aksit është ajo që Franco Purini e cilëson si një “vektor fluksesh energjie perspektivash pamore”<sup>2</sup>. Interpretimi i aksit si një vektor fluksesh energjie perspektivash pamore të ndryshme manifestohet më së miri në zonat urbane ku raporti midis ndërtesave dhe aksit (rrugës) është i drejtpërdrejtë, madje shpesh herë aksi është derivat i vendosjes

paraprake të ndërtesave. Në këtë rast këta dy përbërës të hapësirës së vendbanimit – ploti i ndërtesave dhe boshi i rrugëve apo shesheve – qëndrojnë në një marrdhënie dialektike duke krijuar tensione hapësinore në gjëndje për të formuar materialin kryesor të qytetit tradicional. Ky raport dialektik humbet në qytetin linear dhe mungon tërësisht në formën e parë të shprehjes së aksit duke qënë se aty prania e ndërtesave presupozohet se nuk duhet të ekzistojë. Në qytetin linear humbja e këtij raporti nuk duhet kërkuar në mungesën e ndonjërit prej përbërësve të sipërpërmëndur, që qartësisht janë të pranishëm, por në ç’ekuilibrimin e proporcioneve dhe të distancave midis tyre. Nëse në rastin e tretë, atë urban, marrdhënia e tyre është e drejtpërdrejtë, në atë të dytin kjo marrdhënie humbet për krijimin e zonave “jastëk/shërbyese” dhe respektimin e fashave ku nuk mund të ndërtohet. Nga kjo pikëpamje krijimi dhe ndërtimi i vendbanimeve mbi konceptin linear bën që të humbasë dimensionin urban tradicional i formuar nga kontrasti i ndërtesave me boshin që i rrethon.

### Vendbanimet lineare

Tipi i vendbanimit linear është i përfaqësuar në historinë e arkitekturës nga një sërë modelesh që për motive teknike, por edhe sepse renditja e tyre nuk ishte qelimi i këtij artikulli, janë lënë jashtë këtij shkrimi. Në këtë artikull tipi linear pasqyrohet me anë të kërkimeve teorike të Arturo Soria Y Mata-s dhe Nikolay Milyutin-it për tu pasuar nga realizimet në modelet e Le Corbusier-it.

Vendbanimi linear i ka rrënjët të “Ciudad

1. Portoghesi, P., *Il progetto per la città Vallo di Diano: una città policentrica dall'unificazione di diciannove comuni*, Kappa, Roma 1981.

2. Purini, F., *Comporre l'Architettura*, Laterza, Roma-Bar i 2000. pp. 143. Duke u përkthyer në shqip “Të kompozosh Arkitekturën”






Fig. 02 Skema e “Qytetit linear” me fasha sipas Nikolay Milyutin në librin *Socgorod në vitin 1930*. (burimi: Edmund Goldzamt, *L’urbanistica dei paesi socialisti - Città, territorio e struttura sociale*, Mazzotta, Milano 1977. pp. 183)

Lineal” i Arturo Soria Y Mata-s<sup>3</sup> (1844 - 1920). Tipi i qytetit i propozuar nga inxhinieri spanjoll paraqet një skeme lineare ku ndërtesat janë të pozicionuara përgjate një “aksi” qendror me gjatësi të pakufizuar. Gjerësia e këtij “aksi” e parashikuar rreth dyzete metra është e përbërë nga dy korsi kryesore dhe nga një hekurudhe në dispozicion të trenave. Nga aksi kryesor dalin rrugë dytësore me një interval që shkon nga tetëdhjetë deri në njëqind metra dhe me një gjerësi prej njëzetë metrash që bëjnë të mundur shpërndarjen në thellësi. Kufiri i jashtëm i qytetit materializohet nga një rrugë paralele me aksin kryesor në distancë nga dy qind metra. Në vijën e parë, në të dyja anët e aksit kryesor, janë të përqendruara ndërtesat dhe hapësirat për shërbimet ndaj publikut si dhe zonat e përbashkëta dhe menjëherë pas tyre vijjnë banesat familiare apo individuale. Qyteti linear i Soria Y Mata-s lindi për të qënë një alternativë ndaj modelit të qytetit polar/kompakt. Në thelb të qytetit linear të arkitektit spanjoll qendron ideja e qarkullimit dhe të pozicionimit sa më afër ndaj instrumentave që bëjnë të mundur atë. Në dhjetevjeçarin e fundit të shekullit të XIX

Soria y Mata krijoi një shoqeri ndertimi me emrin “*Compañía Madrileña de Urbanización*”, bleu disa terrene rreth Madridit dhe filloi me ndertimin e qytetit sipas vizionit të tij. Por plani nuk shkoi sipas parashikimeve të arkitektit spanjoll dhe nga projekti fillestar u ndërtua afërsisht një e katërta e tij. Pas këtij dështimi për shkaqe shpronësimi dhe administrative ideja e qytetit linear u “dënua” me një formë refuzimi nga ana praktike, por pati sukses në planet akademike dhe skemat e inxhinierit spanjoll u ripërpunuan dhe ripropozuan nga arkitekti zvicerian Le Corbusier, sikurse do të shohim më poshtë.

Një tjetër model që i përket tipit të vendbanimeve lineare është ai i teorizuar nga arkitekti rus Nikolay Milyutin (1889-1942) në vitin 1930 i cili paraprin kartën e Athinës dhe librin “*Manière de penser l’urbanisme*” i shkruajtur nga Le Corbusier-i dhe i publikuar në vitin 1946. Qyteti Linear i Milyutin-it prezantohet i organizuar në fasha të ndryshme lineare në të cilat zhvillohet një funksion specifik, në dallim nga ai i Soria Y Mata-s që paraqitet homogjen me ndërtesa shërbimesh dhe banimi të organizuara përgjatë aksit kryesor. Skema e qytetit linear të Milyutin-it përbëhet nga gjashtë fasha kryesore (Fig. 2) të renditura më poshte: 1) fasha e hekurudhës, 2) fasha e industrisë dhe e shërbimeve, 3) fasha e gjelbërt me kopështe, 4) fasha e banimit, 5) fashë e gjelbërt-park, 6) zona bujqësore. Mbi këtë koncept linear të qytetit Milyutin-i propozon skemat e lidhjes së pjesës industriale me qendrën e banuar të qytetit Gorkij (Fig. 3). Tipi i qytetit linear i ndarë në fasha të cilat kishin role specifike shfaqet në koherence totale me modelin e zonimit të qytetit të Arkitekturës moderne. Sipas Kenneth Frampton kjo

3. Soria y Mata. A., *La città lineare*, Il Saggiatore, Milano 1968.

ndarje në fasha mbart në vetvete një qellim politik i shpalosur në objektivin për mos të krijuar ndarje klasore duke krijuar një fashë të vetme për banim ku integroheshin si puntorët e industrisë si ata që punonin në zonën bujqësore.<sup>4</sup> Mbi këto dy tipe të vendbanimeve lineare ndërtohet teoria urbane e qyteteve lineare të Le Corbusier.


Le Corbusier ripërpunoi idetë si të Soria Y Mata-s ashtu edhe ato të Nikolay Milyutin-it dhe i publikoi në librin “*Manière de penser l’urbanisme*”<sup>5</sup> në vitin 1946 ku autori propozon projektin e qytetit industrial duke u bazuar mbi një model linear. Nga projektet e Le Corbusier-t që ndjekin skemën lineare mund të theksojmë projektin e tij për fabrikën e kepuceve Bat’a, zhvillimin e qytetit Zlin në Republikën Çeke. Në këtë ndërhyrje arkitekti lidh qendrën e vjetër të Zlin-it me aeroportin në pjesën e sipërme të qytetit me një rrugë për makina ku bashkëngjitur ishte dhe hekurudha kurse në dy anet e rrugës ndodheshin banesat për puntoret dhe kapanonet e fabrikave. Në këtë projekt dallohen qartë ndikimet e mësimave dhe skemave lineare të Arturo Soria Y Mata-s dhe ato të Nikolay Milyutin-it.

## Vendbanimi polar

Krahas modeleve të analizuar në pjesën pararendëse ekzistojnë edhe modelet që janë zhvilluar historikisht në kontekstin evropian, ku qendra urbane është kompakte dhe e agreguar rreth një apo më shumë sheshesh të vendosura në sistem nga gjurmët e rrugëve. Gjatë shekullit XX këto vendbanime nuk përshkohen nga rruga kryesore por kjo e fundit i anashkalon pa

4. Frampton, K., *Storia dell’architettura moderna*, Zanichelli, Bologna 2008. 4ed. pp, 202-204, 207, 210.

5. Jeanneret, C.-É., (*Le Corbusier*), *Manière de penser l’urbanisme*, Paris, 1946.



u futur në zonën e banuar duke ruajtur kështu natyrën e tyre fillestare kompakte. Shembujt janë të shumtë në të gjithë Evropën duke filluar nga qytetet italiane e ato franceze, gjermane, hollandeze apo belge.

Vendbanimet polare në diferencë nga ato lineare kanë origjinë shumë të hershme, ato mund të shkonë deri të vendbanimet e para ku njeriu vendos të shndërrojë organizimin e tij social/ekonomik nga një formë jetese endacake e ngritur mbi gjuetinë e një organizim fiks, i qendrueshëm i ngritur mbi bujqësinë. Kjo periudhë përkon me fundin e epokës Neolitike. Historia e vendbanimeve kalon pastaj nëpërmjet atyre Sumere dhe Asire që kanë origjinë rreth pesë mijë vite më parë për të shkuar e vendbanimet Minoike dhe më vonë e qytet/shtetet greke rreth shekullit V para erës sonë. Nga fillesat e vendbanimeve deri në civilizimin minoik kemi të bejmë më tepër me vendbanime të organizuara në një ndërtesë të vetme. Me civilizimin grek kemi dhe fillesat e ndërtimit të një qyteti sipas një projekti siç është rasti i propozuar nga Ipodami i Mileto-s. Këto vendbanime si dhe ato a *Castrum* të periudhës Romake kanë të përbashkët faktin se janë të

Fig. 03 Skema e lidhjeve të industrisë me zonën për banim në Gorcki (projekt i Milyutin-it 1930) 1. Fasha industriale; 2. Fasha e sherbimeve dhe e prodhimit; 3. Fasha e gjelbert me sherbime; 4. Fasha e banimit; 5. Parku. (burimi: Edmund Goldzamt, *L’urbanistica dei paesi socialisti - Città, territorio e struttura sociale*, Mazzotta, Milano 1977. pp. 183)





Fig. 4 Skema të zhvillimit urban të pjesës lindore të qytetit të Tiranës. Në skemë dallohet organizimi Linear me fasha i qytetit përgjatë akseve kryesore që lidhin qytetin me qytete të tjera. Në skemë dallohet se në vijën e parë përgjatë rrugëve gjenden shërbimet dhe funksione prodhuese, në vijën e dytë gjenden godinat e banimit dhe pas zona bujqësore. (Përpunime grafike të autorit).

përqendruara në një pikë të terrenit. Si për arsye ekonomie ashtu edhe për motive luftarake këto vendbanime kërkonin të ishin sa më të përqendruara dhe kryesisht të rrethuara nga mure të trasha dhe të larta. Karakteri i qytetit ngeli i njëjtë, për sa i përket organizimit, edhe në periudhën Mesjetare. E njëjtë, polare, ngeli struktura e vendbanimeve edhe gjatë periudhës së rilindjes. Diferenca e vetme ndaj vendbanimeve të kaluara ishte se në këtë periudhe filloi organizimi i tyre në figura gjeometrike të pastra duke nënshtruar karakteristikat e terrenit ku ndërtoheshin.<sup>6</sup> Ekzemplarë të kësaj periudhe janë qytet Palmanova dhe Grammichele në Itali. Forma e qytetit ngeli e njëjtë si në periudhën iluministe qoftë dhe në atë industriale.<sup>7</sup>

Nga fillimi historik i tyre deri në këtë periudhë vendbanimet karakterizoheshin nga një përqendrim i fortë në sipërfaqe të vogla ku kryesisht në qendrën e tyre

ndodheshin ndërtesat më të rëndësishme – organizative, fetare, kulturore, tregëtare, prodhuese – që shfaqeshin në një hapësirë të madhe siç ishte ajo e sheshit kryesor. Kufiri i këtyre vendbanimeve ndaj natyrës ishte i qartë dhe menjëherë i dallueshëm. Ai gjendej në distancën e disa qindra metrave nga qendra kryesore. Ky organizim i vendbanimeve rreth një qendre (sheshi kryesor) apo një serie qendrash më të vogla, të nderlidhura midis tyre me atë kryesore me anë të akseve, për të formuar një sistem “mbajtës” ku organizohet materia ndërtuese, përbën bazën e atij që quhet qyteti kompakt dhe që këtu është cilësuar si polar për shkak të diferencës që shfaq me atë të organizuar përgjatë një aksi.

Nga ana kompozicionale dhe e organizimit territorial këto vendbanime mund të konsiderohen si pole (qendrat urbane) që lidhen me anë të akseve (rrugëve) me polet e tjera. Në këtë rast aksi është thjesht lidhës dhe nuk paraqet karakter qendrimi.

Mund të deduktojmë pas këtyre dy pjesëve se organizimet e vendbanimeve

6. Morini, M., *Atlante di storia dell'urbanistica: (dalla preistoria all'inizio del sec.20.)*, Hoepli, Milano: 1979.

7. Mbi këtë argument të konfrontohen studimet e Leonardo Benevolo të publikuara nga Laterza në serinë e botimeve “Storia della città. Vol. I-IV” të publikuar nga editore Laterza.

që kemi trashëguar deri më sot mund të klasifikohen në polare dhe lineare. Ekziston dhe rasti i tretë ku këto dy skema fillestare integrohen me njëra tjetrën në një të vetme por ky rast nuk përbën objektin e këtij shkrimi dhe mund të trajtohet në shkrime të tjera.

## Vendbanimi linear në Shqipëri

Në Shqipëri manifestohen të dyja tipet e vendbanimeve të sipërpermendura, si lineare ashtu dhe polare. Ekziston edhe rasti kur të dy tipet integrohen duke formuar një të tretë. Në këtë pjesë do të analizohet tipi i parë, ai i vendbanimit linear. Është e rëndësishme të theksohet fakti se në këtë shkrim janë anashkaluar analizat mbi ato zona ku modeli linear ndërthuret me një model tjetër të organizimit të formës urbane. Kështu janë anashkaluar modelet e lindura nga kryqëzimi i dy modeleve lineare, gjithashtu është lënë mënjanë edhe rasti kur një model linear ndërthuret me një model polar pasi studimet do të kërkonim hapësirën një artikulli tjetër.


Për sa i përket tipit të vendbanimit linear mund të themi se ai u krijua në Shqipëri në mënyrë të pavetdijshme, të paplanifikuar dhe të pastudiuar. Kjo skemë në vendin tonë është produkt i ndërtimeve informale të cilat për pasojë të mungesës së infrastrukturave shpërndarëse tentonin të ngriheshin nga banorët në distancë sa më të shkurtër nga rruga kryesore ( edhe pse tendencat në shkallë me të vogël për të ndërtuar gjatë rruges kryesore kanë ekzistuar edhe më përpara). U formua kështu një model linear informal për të cilin takon administratës publike të kryeje normalizimin e tij. Në këtë panoramë lind dhe qyteti midis Durrësit dhe Tiranës. Në këtë realitet të dy

qytetet e zhvilluara në mënyrë progresive në fillin të mijëvjeçarit të ri janë tashmë duke u “takuar” me njëri-tjetrin. Nëse kjo do të ndodhë i përket të ardhmes por këtu duam thjeshtë të theksojmë se zhvillimi urban i pakontrolluar në Shqipëri çoi në një skemë vendbanimi linear informal. Realitet ky i pranishëm, i pamohueshem, me të cilin duhet të përballemi të gjithë: arkitektë, planifikues, sociologë, antropologë, ekonomistë e politikanë.


Le të analizojmë nga ana morfologjike një pjesë të këtij qyteti dhe pikërisht atë që ndodhet nga dalja e Tiranës nisur nga kthesa e Kamzës deri në Yrshek. Në këtë pjesë të vendbanimit rol kryesor luan superstrada Tiranë-Durrës e cila – njëlloj si te “Ciudad Lineal” i Arturo Soria Y Mata-s apo si të qyteti linear me fasha i Milyutin-it – është boshti kryesor urban. Paralel me të, në të dy krahët e superstradës, janë ndërtuar rrugë të cilat mund t’i quajmë edhe ato kryesore, dhe që në pika të ndryshme janë të lidhura drejtpërdrejt me superstradën me anë të rakordimeve në nivelin e tokës. Në të dyja anët e rrugëve kryesore ngrihen ndërtesa që kryesisht kanë funksione biznesi dhe shërbimi, e rrallë herë mund të gjejmë dhe ndërtesa që kanë funksione banimi. Në këto raste tipi funksional është ai i banesës njëfamiljare apo dy deri në tre familjare (Fig. 4, Fig. 5). Nga rrugët kryesore shkëputen rrugë dytësore që bëjnë shpërndarjen për në brendësi të zonës ku kryesisht gjejmë ndërtesa banimi të tipit vilë me një deri në tre kate. Me kalimin e kohës dhe për shkak të presionit ndërtues, derivat i zgjerimit të qytetit të Tiranës, ka filluar që midis vilave të ngrihen edhe apartamente të organizuar në shumë kate sipas tipit "në linjë", siç është rasti i pallateve të sapondërtuar në



# ARTIKULL SHKENCOR




INRFASTRUKTURA



NDERTESAT



SHERBIMET



BANESAT

Skema diagram ku analizohen infrastruktura, ndërtesat, shërbimet dhe banesat përgjatë aksit Tiranë Durrës në pjesën që ndodhet midis Kthesës së Kamzës dhe Yrshek-ut. Në këto diagrame duket qartë organizimi linear përgjatë aksit kryesor të autostradës dhe rrugëve dytësore që dalin nga ajo. (Përpunime grafike të autorit).

lagjen e quajtur “Fushë-Mëzez”. Analiza e mësipërme e pjesës midis kthesës së kamzës dhe Yrshek-ut ka ngjashmëri analogjike me tipin e propozuar nga arkitekti spanjoll. Tipologjikisht kjo pjesë e vendbanimit mund të cilësohet e ngritur mbi fasha ku mund të dallojmë qartësisht 1) fashën e transportit (autostradë dhe hekurudhë), 2) fashën e shërbimeve, 3) fashën e banesave, 4) zonën bujqësore. Nëse kjo pjesë e analizuar e qytetit do kishte edhe fashat e gjelbërta midis fashës së banimit dhe atyre prodhuese atëherë do të kishim të bënim me një model edhe më kompleks të qytetit linear me fasha të menduar prej Milyutin-it. Për sa i përket boshtit të superstradës duhet theksuar fakti se ai ndan në dysh zonat që shtrihen në krahët e tij, të cilat janë tërësisht të shkëputura dhe pa asnjë marrëdhënie morfologjike ndërmjet njëra tjetrës. Ato janë shumë të ndara dhe lidhjet e vetme që kryhen janë ato të mbikalimeve metalike që kanë rolin kryesor atë të krijimit të një ure vetëm për kalimin e personave nga një anë në tjetrën.

Kjo skemë e sapoanalizuar ku në “vijën e parë” gjenden shërbime të nivelit që kapin edhe atë kombëtar, dhe në vijën e dytë ndodhen ndërtesat rezidenciale është duke u konsoliduar gati në gjithë aksin Durrës-Tiranë. Referenca dhe ngjashmëritë për këtë pjesë të sapo përshkruar me të qytetit linear janë të drejtpërdrejta. Pavarësisht kesaj ngjashmerisë, që ka nevojë për rregullime të metejshme për përmisimin e funksionimit të tyre në përputhje me këto skema lineare. Nëse rrisim panoramën dhe kërkojmë të fusim në fokus qytetin e Durrësit, të Tiranës dhe lidhjen urbane që po formohet midis tyre mund të pohojmë pa hezitim se kjo skemë urbane ka për model atë të një

sistemi metropolitan unazor, me dy pole kryesore Tiranën Durrësin. Ky fenomen ka ndodhur, por në një shkallë me të madh dhe në qytetet e SHBA-s duke krijuar ato që quhen Megalopolis<sup>8</sup>.

## Vendbanimi polar në Shqipëri

Në Shqipëri me zhvillimin ka pasur dhe ndërhyrje territoriale sipas tipit polar, ku rruga infrastrukturore kalon jashtë qendrës së banuar me qëllim shkurtimin e kohës për të arritur në destinacion. Kjo mënyrë projektimi është zhvilluar njëkohësisht me atë të tipit linear dhe gjithashtu i përket eksperiencës së njëzetë e pesë viteve të fundit.

Ndërhyrjet në nivel planifikimi të vendbanimeve në vendin tonë, në dallim me ato të shteteve fqinjë apo ato evropiane, janë eksperiencia që i përkasin viteve të fundit. Duhet theksuar se planifikimi i vendbanimeve dhe i territorit në Shqipëri deri në fillimet e viteve '90 ishte në fazë embrionale. Bëhej fjalë kryesisht për përcaktimin e traseve rrugore, hekurudhore e deri në përcaktimin e zonave ku do ndërtohej dhe ku jo. Po të anashkalojmë eksperiencat italiane të paraluftës së dytë botësore të cilat i përkisnin projektimit të qendrës urbane në brendësi dhe jo mënyrës



se si lidhesin ato me njëra tjetrën, mund të themi se ndërhyrje të tilla janë kryer duke filluar që nga periudha diktatoriale. Gjatë kësaj periudhe rruga interurbane kalon (deperton) në brendësi.

Iteri përshkues ishte: rrugë kryesore interurbane që në momentin që futej në qytet transformohej kryesisht në boulevard – shesh kryesor ku shfaqeshin ndërtesat kryesore që manifestonin karakteret arkitektonike më të theksuara – rrugë dalëse. Në të gjitha vendbanimet skema projektuese është e njëjtë; shumë e theksuar në vendbanimet e mëdha por e dallueshme edhe në ato më të vogla. Vendbanimet e kësaj periudhe paraqesin një karakter polar/kompakt edhe pse rruga interurbane i

Fig. 05 Skeme diagram me vendbanimet kryesore në Shqipëri ku tregohet raporti i dyfishtë që ka aksi (rruga) me vendbanimet. (Përpunime grafike të autorit).

8. Gottman, J., *Megalopolis. The urbanized northeastern seaboard of the United States, The Twentieth Century Fund, New York 1961.* Emblematik është rasti i Bos-Wash: një vendbanim shumë i madh që tentonte të fillonte prej Boston, Massachusetts kalonte në New York City, Philadelphia, për të përfunduar në Washington, D.C. Dy teoricienet me të mëdhenj të ketij qytet i janë Constantinos Doxiadis (1914-1975) dhe Jean Gottman (1915 - 1994). Ky i fundit teorizon dhe qytetin e Megalopolis në librin me të njëjtin titull. Edhe pse Megalopolis-i i Gottman i ngjan më tepër një qasjeje ku qendrat specifike të vendbanimeve janë të lidhura me anë të akseve dhe mund të shtohet se lidhja midis qendrave mund të konsiderohet si një qytet linear. Teoria e tyre nuk ben asgjë me teper sesa të propozojë një zhvillim urban të mbështetur në aksat kryesore rrugore ku here pas here nga mbivendosja e ketyre akseve krijohen skema urbane apo metropolitane policentrike. Nga ana tjetër duhet theksuar se për herë të parë për megalopolis (qytet të madh në shkallë rajonale) nuk kanë folur autorët e sipërpërmendur por Patrick Geddes më 1915 në librin e tij "Cities in Evolution" dhe Lewis Mumford (student i Geddes) më 1938 në librin "The Culture of Cities". Këta autorë përshkruan në shkrimet e tyre karakterin e ketij tipi vendbanimi por pa e konkretizuar në shembuj konkret, ndryshe nga kontributi që dhanë Dioxiadis dhe Gottman.



depërton në brendësi. Kjo ndodh për shkak se infrastrukturaturat e kohës duke mos qënë të ngarkuara nga prania e automjeteve shfaqin dimensione të përmbajtura. Në këtë periudhë raporti midis rrugës dhe ndërtesave është i drejtëpërdrejtë dhe imazhi i hapësirës urbane ndërtohet nga kjo marrdhënie dialektike.

Rasti studimor i marrë për shembull në këtë pjesë është ai i qytetit të Kavajës për të cilin arkitekti Isuf Sukaj shkruan “*Rruga kryesore e qytetit sipas drejtimit veri-jug, {...} e ashtuquajtur ‘Rruga e Madhe’ është trasuar në rrugën e vjetër ekzistuese që lidh qytetin e Kavajës nga veriu me Durrësin dhe nga jugu me Rrogozhinë. Kjo zgjedhje nuk është vetëm tipar i qytetit të Kavajës, por tipari shumë qyteteve shqipëtare fushore ku rrugët kryesore janë vazhdim i atyre që lidhin qytetin me qendrat e tjera*”<sup>9</sup>. Ky tipar i qytetit të Kavajës siç e thekson dhe Sukaj është karakter përbërës i shumë vendbanimeve qoftë urbane, qoftë rurale, në vendin tone. Duhet theksuar se ky karakter ku rruga kryesore kalon në qendrën e qytetit nuk i heq natyrën e tij kompakte dhe nuk e bën atë të tipit linear.

Qyteti i Kavajës paraqet një skemë të qartë kompozitive në nivel urban. Siç shkruan edhe Sukaj “*Kjo vihet re në kompozimin e lirë të lagjeve të banimit dhe në skemën e pastër të rrjetit rrugor që ka si shtyllë kurrizore rrugën e madhe, nga e cila, pingul me të dhe nga të dyja anët e saj, nisën rrugët dhe rrugicat që formojnë njësi të vogla banimi*”<sup>10</sup>. Karakteri kompozitiv i Kavajës edhe pse ka një shtrirje përgjatë një aksi kryesor nuk është linear por kompakt/polar dhe kjo për shkak të “shartimeve” rrugore pingule me atë kryesore, të cilat kërkojnë me anë të përqendrimeve të

materies ndërtuese të përcaktojnë qendra të vogla që thyejnë pikërisht karakterin linear. Gjurma e pëlhurës shpërndarëse të këtij qyteti e cilësuar nga Sukaj “*në formë T*” është një provë tjetër e karakterit kompakt të vendbanimit. Këtu nuk duhet anashkaluar fakti se jemi duke folur për Kavajën e para viteve ’90 dhe se pas këtyre viteve shtrirja e re e Kavajës ka një trajtë gati lineare të ngritur kryesisht përgjatë superstradës.

Siç u përmend deri këtu bypass-imi (anashkalimi) i vendbanimeve është një strategji që i përket njëzet viteve të fundit dhe motivi kryesor i ndërtimit të tyre është ai i shkurtimit të distancave të largëta dhe lirimi i qendrave të vendbanimeve nga trafiku automobilistik. Midis ndërhyrjeve të tilla, ndër të parat ka qënë anashkalimi i qytetit të Lushnjes dhe Kavajës nga superstrada që lidh Durrësin me Vlorën. Aktualisht janë duke u ndërtuar anashkalimi i qytetit të Fierit, ai i Urës Vajguore i cili sapo ka përfunduar por edhe shumë të tjerë janë në projekt (Fig. 6). Në shumicën e infrastrukturave që janë në projekt e siper është parashikuar anashkalimi i qendrave urbane e cila përforcon karakterin e qytetit polar duke e bërë atë më kompakt.

## Përfundime

Po të vërejmë se si ka ndodhur zhvillimi urban në njëzetë e pesë vitet e fundit në vendin tonë dallojmë dy linja kryesore: atë të vendbanimit linear dhe atë të vendbanimit polar. Të dy shembujt kanë histori dhe pozicione gjeografike të ndryshme. Nese tipin linear mund ta konsiderojmë si një mënyrë e të menduarit të qytetit i cili ka një histori prej gati një shekulli e gjysmë ndërsa, në rastet informale është produkt i një kulture konsumi të shfrenuar të terrenit dhe të pasurive natyrore; nuk mund të themi të

9. Sukaj, I., *Urbanistika dhe Arkitektura e qytetit të Kavajës; vështrim i zhvillimit historik*, Ombra GVG, Tiranë 1998. pp. 27.

10. Sukaj, I., *vepër e cituar*, pp. 28.

njejtën gjë për tipin e dytë. Ai i përket një kulture më të rrënjësuar në histori dhe më tradicionale.

Duke u bazuar mbi analizat e paraqitura më sipër, mund të themi se ajo pjesë e realitetit urban informal e cila është vetë organizuar duke marrë trajtën e një qyteti lineare, në gjëndjen aktuale shfaq një seri me problematika si në imazhin urban ashtu edhe në funksionimin e transportit. Kjo situatë mund të transformohet me vetëm pak ndryshime, në një qytet linear organizuar me fasha. Rasti i analizuar nga kthesa e Kamzës deri në Yrshek paraqet qartësishtë ngjashmëri me skemën e qytetit linear me fasha nga Milyutin-i por edhe vendbanimet e tjera informale të cilat janë organizuar përgjatë rrugës kryesore mund të transformohen duke ndjekur po të njejtën skemë.

Për sa i përket qendrave të konsoliduara të cilat në këtë shkrim janë konsideruar si polare mund të themi se bypass-imi (anashkalimi) i tyre shfaqet si një strategji efikase për përmimësimin e tyre për disa motive. Së pari, sepse shmangim trafikun e shpejtë nga zona urbane. Duke bërë këtë veprim jemi në gjëndje të eliminojmë shqetësimet pamore apo zhurmat të derivuara nga mbiprezenca e makinave në brendësi të zonës urbane. Motiv tjetër është edhe moscopetimi i zonës së banuar në pjesë që nuk komunikojnë mirë me njëra tjetrën duke krijuar një fragmentim jo efikas si nga ana funksionale ashtu dhe nga ajo arkitektonike. Pasojë e fragmentimit arkitektonik është shpërbërja e imazhit të qytetit si një vepër njerëzore që mbart vërdijen, marrdhëniet shoqërore dhe intuitën e banorëve, në gjëndje për të përcjellë kulturën e shtresëzuar në shekuj .

## Literatura

- Édouard Jeanneret - Charles (Le Corbusier), *Manière de penser l'urbanisme*, Paris, 1946.
- Goldzamt Edmund, *L'urbanistica dei paesi socialisti - Città, territorio e struttura sociale*, Mazzotta, Milano 1977.
- Gottman Jean, *Megalopolis. The urbanized northeastern seaboard of the United States*, The Twentieth Century Fund, New York 1961.
- Morini Mario, *Atlante di storia dell'urbanistica: (dalla preistoria all'inizio del sec.20.)*, Hoepli, Milano: 1979.
- Portoghesi Paolo, *Il progetto per la città Vallo d i Diano: una città policentrica dall'unificazione d i diciannove comuni*, Kappa, Roma 1981.
- Purini Franco, *Comporre l'Architettura*, Laterza, Roma-Bar i 2000.
- Soria y Mata Arturo, *La città lineare*, Il Saggiatore, Milano 1968.
- Sukaj Isuf, *Urbanistika dhe Arkitektura e qytetit të Kavajës; vështrim i zhvillimit historik*, Ombra GVG, Tiranë 1998.



# PROCESI I FORMËSIMIT TË NDËRTESESË SË MUZEUT NË SHQIPËRI:

Nga “para muzeu” deri në fund të Luftës së Dytë Botërore

## Abstrakt:

Ndërtesat e muzeve në Shqipëri të cilat strehuan, ruajtën dhe ekspozuan trashëgiminë materiale të shqiptarëve, kanë kaluar në një proces relativisht të gjatë reformimi dhe përshtatje, proces i cili vazhdon edhe në ditët e sotme. Artikulli ka për qëllim të paraqesë, nëpërmjet hulumtimit historik, procesin e formimit të tipologjisë së ndërtesës së muzeut në Shqipëri që nga fillimet dhe deri në fund të Luftës së Dytë Botërore. Ky proces evolutiv është paraqitur në artikull në mënyrë kronologjike, shoqëruar nga konteksti historiko-politik dhe nga zhvillimet urbane e arkitektonike të vendit. Evidentimi i fazave historike të zhvillimit të ndërtesës së muzeut dhe analizimi i karakteristikave arkitektonike të secilës fazë është parë në paralelizëm me zhvillimin e ndërtesave të muzeut në botë.

Për të kryer procesin e tij krijues, arkitektit i duhet të njohë së pari historikun e formimit të tipologjisë me të cilin ai punon dhe pikërisht për këtë, ky studim do të shërbejë si një reflektim për zhvillimin e ardhshëm të ndërtesës së muzeut në Shqipëri si në aspektin e restaurimit apo ripërshtatjes të ndërtesave ekzistuese, dhe në projektimin dhe ndërtimin e godinave të reja.

Etleva Bushati, Prof. Asc. Florian Nepravishta, Loreta Çapeli  
Fakulteti i Arkitekturës dhe Urbanistikës, UPT

Artikulli u recensua nga Dr. Arch. Lazar Kumaraku



## Hyrje

Vizatimet që na vijnë nga prehistoria, të gjetura në shpella, apo pikturat në vendbanimet neolitike janë shembuj të nevojës themelore të njeriut për të mbledhur dhe prezantuar imazhe dhe objekte, si dhe për ti mbrojtur ato në hapësira të brendshme ekzistuese ose të ndërtuara rishtazi.

Ne “polisin” Grek gjendeshin ndërtesa të vogla të quajtura “Pinakothekë” në të cilat ekspozoheshin piktura për tu vizituar nga qytetarët. Në botën antike ishte veçanërisht i famshëm “Mouseion” i Aleksandrisë. Muzetë e para si, muzeu i Vatikanit, i Louvre, Hermitage, etj. u vendosen në ambientet e rezidencave luksoze apo pallateve mbretërore. “Galeritë” dhe “dhomat e kurioziteteve” ruanin dhe ekspozonin koleksionet private. Këto hapësira, të cilat ishin projektuar për të plotësuar funksione të ndryshme dhe jo për të ekspozuar, patën një ndikim shumë të madh në zhvillimin e tipologjisë së ndërtesës së muzeut<sup>1</sup>.

Kuptimin e sotëm termi “muze” e mori në fillimin e shekullit të XIX, në këtë periudhë emërtimi muze nënkuptonte një ndërtesë ku ruheshin dhe ekspozoheshin materiale të trashëgimisë kulturore, në

të cilën publiku kishte qasje. Formimi i tipologjisë së muzeut më shumë se çdo lloj tjetër ndërtese na tregon se arkitektura jo vetëm shfaqet nëpërmjet tipologjive, por prodhohet nga ato.

## Konteksti shqiptar

Historia e zhvillimit të muzeve në Shqipëri hedh bazat e veta dhe ka zanafillën në gërmimet arkeologjike. Gërmimet e para, të dokumentuara, i përkasin shekullit të XIX. Ato janë kryer nga Shtjefën Gjeçovi, etnografi, arkeologu dhe studiuesi i kulturës ilire<sup>2</sup> si dhe nga misionet e huaja arkeologjike. Në fund të shekullit të XIX studiues dhe arkeologë të huaj interesohen për të kryer gërmime arkeologjike në Shqipëri. Interesat e para për gërmime arkeologjike shfaqen nga Austro-Hungaria në 1892, më pas misioni arkeologjik francez me në krye Leon Rejn dhe misioni arkeologjik italian i kryesuar nga Ugolini e i pasuar nga Pirro Marconi, Mustilli e Sestieri<sup>3</sup>.

Gjetjet arkeologjike të këtyre ekspeditave ishin të shumta dhe me shumë vlera për historinë e vendit tonë. Ruajtja e tyre në kushte të përshtatshme për kohën, ekspozimi për

1. Geoffrey L. *The history of museums*. Encyclopaedia Britannica. <http://www.britannica.com>

2. Adhami S. 2001. *Muzeologjia Shqiptare*. Tiranë

3. Ibid.



publikun dhe nevoja për ti studiuar sillte si domosdoshmëri ngritjen e godinave të muzeve.

Duke qenë se muzetë janë pasqyrë e kohës së cilës i përkasin, natyrshëm konstatohet se rrethanat historike, politike ekonomike, zhvillimet urbane dhe arkitektonike, sociale dhe kulturore kthehen në faktorë të rëndësishëm, të cilët ndikojnë në projektimin dhe ndërtimin e godinave të muzeve. Në formësimin dhe evoluimin e tipologjisë së muzeut ndikimi i faktorëve të mësipërm është dukshëm i evidentuar dhe e ndanë historinë e godinës së muzeut shqiptar në disa faza zhvillimi:

- Fillesat e para si bërthamë e tipologjisë, shekulli XIX deri në fillimin e shekullit të XX;
- Evoluimi tipologjik i ndërtesës së muzeut nga 1920 deri në vitin 1944;
- Ndërtesa e muzeut pas Luftës së Dytë Botërore deri në vitet '90;
- Ndërtesa e muzeut pas viteve '90.

Në këtë studim trajtohen dy fazat e para të zhvillimit të muzeut, të cilat korrespondojnë me përfundimin e Luftës së Dytë Botërore.

## **Fillesat e para si bërthamë e tipologjisë, shekulli XIX deri në fillimin e shekullit të XX. "Para muzeu"**

Krijimi i muzeve publike në shekullin e XVIII në Evropë dhe konsolidimi i tipologjisë arkitektonike të muzeut të shekullit të XIX nuk kishte se si të mos influenconte sado pak dhe klimën intelektuale shqiptare të kohës. Muzetë e para shqiptare u formuan si koleksione private, të cilat ngjasojnë me "kabinetet e kurioziteteve" duke ndjekur në mënyrë



Fig. 1 Ambientet e muzeut në kolegjin Saverian



Fig. 2 Ambientet e muzeut në kolegjin Franceskan.

modeste historinë e krijimit të muzeve Evropiane. Krijimi i muzeve të parë shqiptarë është i lidhur me koleksionet private.

Në fund të shekullit të XIX në Shkodër ekzistonin tre muze. Në 1880 dhe 1890 themelohen dy muze, të cilët janë dy muzetë e para shqiptare, të njohura si muzeu i Jezuitëve dhe ai i Françeskanëve (Fig. 1, 2)<sup>4</sup>. Këto muze u ngritën dhe u pasuruan me objekte të zbuluara nga gërmimet arkeologjike të kryera nga Shtjefën Gjeçovi dhe priftërinjtë katolikë. Gjithashtu pa një datë të saktë përmendet dhe muzeu i Kalasë Rozafa pjesë e koleksionit të familjes së Bushatllinjve<sup>5</sup>. Këto muze përfaqësojnë dy koncepte të muzeut atë privat si dhe muzeun e përdorur për qëllime mësimore.

Në këto muze të para fokusi vihet tek përmbajtja e muzeut më shumë se sa tek hapësira ku objektet do të vendoseshin.

4. Adhami S. 2001. Muzeologjia Shqiptare. Tiranë

5. Gjipali, I. 1998. Nga muzeu arkeologjik-etnografik tek muzeutë e profilizuar arkeologjik. Iliria Nr. 1-2, Tiranë



Arkitektura e interiorit dhe eksterierit nuk përbënte ndonjë sfond të rëndësishëm për objektet e ekspozuara. Ndërtesa e muzeut akoma nuk ishte formuar si tipologji dhe emërtimi “muze” nënkuptonte koleksionin dhe jo ndërtesën.

Perceptimi i koleksioneve si private, më vonë si mësimore dhe transformimi i tyre në koleksione të vizitueshme për publikun çuan drejt formimit të tipologjisë së ndërtesës, e cila do të strehonte, mbronte dhe ekspozonte koleksionet.

Koleksionet private u ekspozuan fillimisht në ambientet e godinave, të cilat kishin tjetër funksion dhe nuk ishin të hapura për publikun. Ndërtesat e kolegjeve katolike, sallat e tyre të përshtatura për muze krijuan një nocion fillestar të tipologjisë së muzeut në vendin tonë. Zhvillimi i mëvonshëm i të cilit do të reflektojë në sintezën e tij këto elemente fillestare.

Koleksionet të cilat i përkisnin priftërinjve katolikë, ato të mëvonshmet

të familjeve aristokratike si dhe gërmimet e misioneve të huaja arkeologjike formuan bazën e koleksioneve të muzeve shqiptare dhe sollën si domosdoshmëri projektimin e ndërtesave të muzeve me karakteristika specifike në periudha të ndryshme të zhvillimit shoqëror.

### **Evoluimi tipologjik dhe historik i ndërtesës së muzeut në periudhën 1920 deri 1944**

Situata politike e vendit në fillimin e shekullit të XX kishte ndryshuar. Vendi ishte shkëputur nga perandoria otomane, ishte shpallur Pavarësia në 1912 dhe në 1920 qeveria e zgjedhur nga Kongresi i Lushnjës, vendosi Tiranën kryeqytet. Evidentimi i vazhdimësisë së historisë dhe kulturës së një kombi u bë pjesë e politikës së qeverisë së re, e cila ndikoi në intensifikimin e gërmimeve arkeologjike në fillimin e shekullit të XX. Nga gërmimet

Fig. 3 Plani i urbanistik i Tiranës 1921, S. Frashëri (burimi: AQTN, Tiranë)





arkeologjike të studiuesve shqiptarë dhe të huaj u zbuluan vlera të mëdha të trashëgimisë sonë. Për të mbështetur këtë situatë, shkrime të ndryshme të kohës trajtonin domosdoshmërinë e ndërtimit të një muzeu kombëtar në Tiranë<sup>6</sup>. Kjo periudhë karakterizohet nga përpjekje të shumta për ndërtimin e muzeve, por kushtet ekonomiko – politike dhe nevojat e shumta që kishte vendi, nuk e mundësuan realizimin e këtyre projekteve, siç tashmë kishte ndodhur në Evropë.

Qyteti i Tiranës i fillimit të viteve '20 trashëgon një strukturë urbane spontane të shtrirë dhe të copëtuar, në të cilën bënin pjesë dy zona: ajo e banimit dhe ekonomike, të lidhura me një sërë rrugësh e rrugicash të ngushta e herë-herë pa krye (Fig. 3). Përpjekjet për të ndërtuar një godinë për muzeun kombëtar konkretizohen në vitin 1922. Ndërtesa e muzeut kombëtar, një ndërtesë një katëshe, me një volum kompakt të mbuluar me çati, me një arkitekturë pa shumë pretendime kishte katër dhoma ekspozimi (Fig. 4). Kemi të bëjmë me një ndërtesë me mure mbajtëse e përbërë nga dhoma ekspozimi dhe korridor. Planimetria e muzeut aludonte

të pasqyronte tipologjinë e muzeut “pallat” i përbërë nga dhoma dhe galeri, ndërkohë që arkitektura e ndërtesës ishte pasqyrë e kontekstit urban dhe arkitektonik të qytetit të Tiranës në vitet '20.

Në një stil të varfër, shpesh e etiketuar si një ndërtesë jo dinjitoze për muzeun kombëtar ajo shembet në 1925. Arsyet e shembjes së ndërtesës jepen nga dy autorë të ndryshëm. S. Adhami shkruan se ndërtesa u shemb për arsye të një konflikti pronësie, ndërsa I. Gjipali citon si arsye zbatimin e planit të parë urbanistik të Tiranës hartuar nga A. Brasini në 1925-26. Duket se mos arritja e pritshmërive të intelektualëve të kohës për ndërtesën e muzeut kombëtar dhe transformimi i strukturës urbane dhe arkitektonike të Tiranës justifikoi shembjen e ndërtesës me shpresën për të ndërtuar një godinë të re. Muzeu Kombëtar u vendos në ambientet e ish bibliotekës kombëtare.

Qytetet shqiptare nga viti 1925 deri në vitin 1943 u futën në një fazë të re të zhvillimit të tyre urbanistik. Planet urbanistike të këtyre viteve kërkonin të transformonin qytetet shqiptare në qytete Evropiane të bazuara mbi koncepte

6. Adhami S. 2001. *Muzeologjia Shqiptare. Tiranë*

profesionale dhe planifikuese. Arkitektë kryesisht të huaj (A. Brasini, H. Köhler, F. Di Fausto, G. Bosio, G. Bertè, etj.) punuan për hartimin e planeve urbanistike dhe projektimin e ndërtesave publike për disa qytete të Shqipërisë, ndër të cilat gjejmë propozime edhe për godina muzesh të pozicionuara në qendër, pranë ndërtesave të rëndësishme administrative. Në këtë hark kohor, tipologjia e muzeut shqiptar, formësohet dhe zhvillohet e ndikuar nga situata e re urbane dhe arkitektonike si dhe nga tipologjia e muzeut evropian. Projektet e para të ndërtesave të muzeve hartohen nga po të njëjtët arkitektë të huaj, të cilët lanë gjurmë në formimin urbanistik dhe arkitekturor të shumë qyteteve shqiptare.

Nën ndikimin e arkitektëve dhe arkeologëve të huaj tipologjia e ndërtesës së muzeut zhvillohet sipas dy nëntipeve:

- ndërtesa të projektuara për muze;
- ndërtesa ekzistuese të ripërdorura si muze.

Përprojekjet për të ngritur muze sipas njërit apo tjetrit nëntip, u bënë kryesisht në Tiranë si dhe pranë qendrave arkeologjike, të cilat studimi i trajton në mënyrë kronologjike.

## Ndërtesat e projektuara për muze nga 1920 deri 1944

Artefaktet e shumta dhe me shumë vlera të zbuluara në Apoloni nga grupi i arkeologëve francezë, i drejtuar nga Leon Rej, ruheshin në ambiente krejtësisht të papërshtatshme. Në këtë situatë përprojekjet për të ndërtuar një godinë të re për muze, u fokusuan në zonat afër qendrave arkeologjike ku kryheshin gërmimet. Kështu, në 1924, fillon ndërtimi i një godine të re për muzeun arkeologjik

të Fierit, sipas projektit të arkitektit francez Grand, i cili nuk arriti të përfundohej për mungesë fondesh. Projekti nuk ndodhet në arkivat shqiptare, por studiuesi S. Adhami shkruan:

*“ ... u vunë themelet me një ceremoni madhështore, dhe sipas projektit të arkitektit frëng Grand, u ngritën muret deri në një metër përmbi sipërfaqe, por fatkeqësisht puna mbeti me kaq”.*

Rasti pasardhës na paraqitet në Tiranë, ku ndihej akoma domosdoshmëria e ngritjes së një muzeu pasi Muzeu Kombëtar vazhdonte të ishte i akomoduar në ambientet e bibliotekës. Në vitin 1928 arkitekti austriak H. Köhler harton një projekt për Muzeun Kombëtar në të cilin propozonte një godinë që do të kishte dy funksione: bibliotekë (kati përdhe) dhe muze (kati i parë). Nga materialet arkivore të gjetura nuk kuptohet se ku mendohej të ndërtohej muzeu. Në planvendosjen e ndërtesës lexohet qartë sistemi ortogonal rrugor i propozuar nga Köhler dhe Frashëri në planin urbanistik të Tiranës të viteve 1930.

Godina e re, në formë L, i bashkëngjitet një tjetre ekzistuese duke respektuar formën gjeometrike dhe proporcionet e saj (Fig. 5). Ajo është konceptuar me dy volume me lartësi 9 metra dhe 14 metra, në të cilat lexohet ritmi i dritareve të harkuara. Muzeu është vendosur në katin e parë në një ambient të hapur i tipit galeri (18m x 8.6 m) pa ndarje, me parete perimetrale për ekspozim dhe me ndriçim natyral nga sipër. Një sallë e dytë ekspozimi (me dimensione 6.5 m x 4.5 m) në disnivel nga salla kryesore plotëson itinerarin e muzeut. Interesante është vendosja e pajisjeve për ngrohje në






Fig. 5




Fig. 6




Fig. 7




Fig. 8

Fig. 5. H. Köhler, Muzeu Kombëtar 1928, Plani i Përgjithshëm (AQTN, Tiranë)

Fig. 6. H. Köhler, Muzeu Kombëtar 1928, Pamje, (burimi: AQT Tiranë)

Fig. 7. H. Köhler, Muzeu Kombëtar 1928, Plani katit përdhe dhe katit të parë, (burimi: AQTN, Tiranë)

Fig. 8. H. Köhler, Muzeu Kombëtar 1928, Prenje, (burimi: AQTN, Tiranë)

katit përdhe, për të siguruar një klimë të përshtatshme për ruajtjen e artefakteve të ekspozuara (Fig. 6, 7, 8).

Transformimi shumë i shpejtë dhe i vazhdueshëm i Tiranës së këtyre viteve, propozimi i disa planeve urbanistike për zhvillimin e qytetit si dhe kërkesa për të pasur një ndërtesë të denjë për Muzeun Kombëtar janë disa nga arsytet për të cilat nuk u realizua ky projekt.

Në planin urbanistik të 1930 për Tiranën, i propozuar nga arkitekti

fiorentin Florestano Di Fausto, sheshi qendror zhvillohet në një formë drejtkëndore, i rrethuar nga ndërtesat administrative, të cilat formojnë një hapësirë rrethore në skajin jugor dhe një tjetër në formë hegzagoni në skajin verior.

Pjesë e varianteve të planit urbanistik të Di Fausto-s ishte dhe ndërtesa e Muzeut Kombëtar, e cila vinte si kërkesë e Ministrisë Shqiptare të Arsimit. Në këtë plan ndërtesa e Muzeut Kombëtar, pozicionohet në skajin verior të sheshit duke mbyllur skenografinë monumentale të tij (Fig. 9, 11). Nga studimi i dokumenteve arkivore kuptohet se puna për hartimin e projektit të Muzeut Kombëtar nga Di Fausto ka filluar që në vitin 1930 dhe projekti përfundimtar daton në dhjetor 1932. Ministria e Arsimit të asaj kohe sugjeronte që muzeu duhet të kishte disa salla ekspozimi ndër to edhe salla ekspozimi për pikturë, skulpturë, armë si dhe ambiente për zyra. Kërkohej gjithashtu që arkitektura e godinës të ishte në harmoni me ndërtesat e sheshit

Arkitektura e muzeut frymëzohej nga stili i Rilindjes Italiane i interpretuar në një mënyrë moderne nga F. Di Fausto. Vështruar në aspektin tipologjik projekti ndërthur principet e themeluara nga shembujt e parë të tipologjisë së muzeut “pallat” me influencën e fortë të tipologjisë së muzeut Durantin dhe të Schinkel-it (Altes Museum). Sallat e ekspozimit të projektuara sipas konceptit të “pallatit” janë pjesë e zgjidhjes planimetricke dhe arkitekturës Durantine të interierit. Në projektin e muzeut ideal, të propozuar nga J. N. Louis Durand, arkitektura, skulptura dhe piktura janë të harmonizuara në një mjedis të përbashkët artistik. Arkitektura e muzeut ishte shumë më tepër se shkallë

dhe përmbajtje. Këto parime ndihen të reflektuara qartazi në muzeun e projektuar nga Di Fausto. Trajtimi i kolonadës së portikut në oborrin e brendshëm, i pareteve vertikale shpesh mure strukturale si dhe prania e nikjeve të shumta në interior është influencë e këtyre modeleve. Po ashtu prania e oborrit të brendshëm, i cili perceptohej nga hyrja dhe organizimi i sallave të ekspozimit rreth tij reflekton influencën e modelit Durantin dhe të K. F. Schinkel-it. Duhet theksuar se autori kishte eksperiencën e muzeut Italian të kësaj periudhe dhe gjithashtu në zgjidhjen e tij një ndikim të madh pati stofi urban ekzistues dhe plani urbanistik i Tiranës.

Këto dy faktorë ndikuan në zgjidhjen planimetricke dhe arkitektonike të muzeut. Ndërtesa në plan ka një formë asimetrike me një strukturë të përzier betonarme dhe muraturë (Fig. 12, 13, 14). Për të bërë një integrim morfologjik me stofin urban pjesa e pasme konceptohet si një strukturë dy katëshe, e cila lidhet mirë me ndërtime të përreth. Ndërsa pjesa e hyrjes është një volum tre katësh e harmonizuar me ndërtesat e sheshit Skënderbej (Fig. 10, 16). Fasada kryesore monumentale, me një hyrje madhështore në stilin neo-klasik (Fig. 15), ka një simetri të fortë ndaj aksit të bulevardit dhe krijon një uniformitet arkitektonik me ndërtesën e Bashkisë dhe me Ministrinë e Ekonomisë (ndërtesa ngjitur).

Arkitektura e muzeut është në harmoni me stilin e godinave të sheshit Skënderbej. Masivizmi, jo transparencja e pareteve, kornizat e rënda ndarëse të kateve, hyrja monumentale përkonin shumë mirë me arkitekturën dhe stilin e ndërtesave të muzeve të ndërtuara në



Fig. 9 F. Di Fausto, Muzeu Kombëtar, Sheshi Skënderbej – Plani i Përgjithshëm 1930, Pamje nga sipër .



Fig. 10 Foto e sheshit ku do të ndërtohej Muzeu Kombëtar.




Fig. 11 F. Di Fausto, Sheshi Skënderbej plani i përgjithshëm 1930, Planvendosje e Muzeut Kombëtar. (burimi: A Vokshi, 2014).






Fig. 12




Fig. 13




Fig. 14



Fig. 15




Fig. 16

Fig. 12,13,14. F. Di Fausto, Muzeu Kombëtar, 1932. Plani Katit Përdhe, Katit Parë dhe Katit të Dytë. (burimi: AQTN, Tiranë)

Fig. 15. F. Di Fausto, Muzeu Kombëtar 1932. Pamje. (burimi: AQT, Tiranë)

Fig. 16. F. Di Fausto, Muzeu Kombëtar 1932. Prerje AB, (burimi: AQTN, Tiranë)

Evropë. Arkitektura e muzeut ka një gjuhë plastike e arritur nga kornizimet e dritareve, dekorimet, skulpturat, daljet e volumeve dhe nga loja e dritë hijeve të krijuara me elementë dekorativ apo struktural. Materialet e përdorura, bazamenti prej guri të latuar, suvatë e trasha të fasadave janë sfondi i të gjithë dinamikës dekorative të ndërtesës.

Projekti i Muzeut Kombëtar i hartuar nga Di Fausto shënon gjurmën e parë në projektimin e muzeut shqiptar në sinkroni me tendencat Evropiane të zhvillimit të tipologjisë së muzeut duke reflektuar karakteristikat thelbësore të tij.

Plani urbanistik i Tiranës i hartuar nga F. Di Fausto u zbatua në mënyrë të pjesshme. Në pjesën veriore të tij u ndërtua vetëm Bashkia e Tiranës ndërsa ndërtesat e tjera të propozuara nga ai mbetën të pa realizuara.

Bashkë me F. Di Fausto në Shqipëri punoi edhe arkitekti e inxhinieri italian Giulio Bertè, autor i shumë projekteve të rëndësishme publike dhe private. Aktiviteti i tij projektues në Shqipëri daton në fillim të viteve '30 dhe vazhdon me bashkëpunimin e tij me arkitektët italianë racionalistë, të cilët arritën në Tiranë në 1939. Ndër projektet e hartuara prej tij është dhe ai i Muzeut Kombëtar. Autori harton dy projekte për Muzeun Kombëtar, njërin në vitin 1930 dhe tjetrin në 1938.

Referuar dokumentave të AQTV, projekti i muzeut i datuar në 1930 na paraqitet si një bllok kompakt dykatësh, me një stil neo-klasik. Në fasadën kryesore të muzeut elementi më dominant është hyrja deri diku pompoze, e cila spikat ndaj trajtimeve të thjeshta me kornizime lineare, të pjesës tjetër të fasadës (Fig. 20).

Projekti është i punuar në tre variante të cilat i përshkon i njëjti fill, përse i takon zgjidhjes planimetrike. Në të tre variantet sallat e ekspozimit janë të pozicionuara rreth një holli qendror i konceptuar si një nyje e fortë lidhëse, skemë kjo e interpretuar dhe e përdorur nga arkitektët e muzeut publik. Me një itinerar të përcaktuar lëvizjeje muzeu organizohet në shtatë salla ekspozimi. Në katin përdhe sallat e ekspozimit kishin dimensione 13 x 6.5 m dhe 8.5 x 6.5 m ndërsa në katin e parë ishin me dimensione më të vogla (Fig. 17). Zvogëlimi i planimetrisë së muzeut në katin e parë bëhej për të mundësuar ndriçimin nga sipër me dritë natyrale të sallave të muzeut (Fig. 18). Ndriçimi nga sipër i muzeut (tashmë tendencë e muzeve evropiane të kohës) realizonte dhe një ventilim të mirë të ambienteve të tij dhe maksimizonte sipërfaqen e ekspozimit në paretet perimetrale të godinës (Fig. 19).

Referuar dokumentave të AQTV, projekti dytë i hartuar nga G. Bertë, për Muzeun Kombëtar daton në 1938. Në këtë periudhë arkitekti kishte përqafuar stilin e arkitekturës racionaliste italiane. Inspirimi nga arkitektura vernakulare tradicionale dhe përkthimi i saj në një gjuhë shprehëse arkitektonike karakterizon krijimtarinë e Bertësë. Stili arkitektonik i përdorur në projektin e Muzeut Kombëtar reflekton këtë influencë.

Muzeu parashikohej të ndërtohej në pjesën fundore të Bulevardit Zogu i I, atje ku më përpara ishte propozuar nga F. Di Fausto ndërtimi i Pallatit Mbretëror. Në plan vendosje ndërtesa e muzeut ka një shtrirje gjatësore prej 85 metra dhe vendoset në kodrën në fund të bulevardit në një lartësi 15 metra mbi kuotën e tij (Fig. 21).







Fig. 17, 18. G. Bertë, Muzeu Kombëtar 1930, Plani Katit Përdhe dhe Katit Parë. (burimi: AQTN, Tiranë).

Fig. 19. G. Bertë, Muzeu Kombëtar 1930, Prerje. (burimi: AQTN, Tiranë).

Fig. 20. G. Bertë, Muzeu Kombëtar 1930, Fasada kryesore. (burimi: AQTN, Tiranë).






Fig. 21. G. Bertè, Muzeu Kombëtar 1938, Planvendosje. (burimi: A Vokshi, 2014)




Fig. 22




Fig. 23

Fig. 22, 23. G. Bertè, Muzeu Kombëtar 1938, Plani katit përdhe dhe katit të parë. (burimi: A Vokshi, 2014)




Fig. 24

Fig. 24 G. Bertè, Muzeu Kombëtar 1938, Pamje e hollit të hyrjes. (burimi: A. Vokshi, 2014).




Fig. 25

Fig. 25. G. Bertè, Muzeu Kombëtar 1938, Prerje. (burimi: A Vokshi, 2014)




Fig. 26

Fig. 26. G. Bertè, Muzeu Kombëtar 1938, Pamje kryesore. (burimi: A. Vokshi, 2014).

Krahasuar me projektin e muzeut të 1930 ky projekt është më i zhvilluar në aspektin planimetrik dhe na paraqitet me një stil tjetër arkitektonik. Skema planimetrike e përdorur ka shtrirje gjatësore në të cilën nuk kemi një nyje qendrore shpërndarëse (muzeu Durantin), por pasazhe të gjata lidhëse të cilat në një gjuhë të re shprehëse evokojnë galeritë e pallateve mbretërore (të interpretuara nga Leo Von Klenze në projektin e Alte Pinakothek). Ndërtesa ka një zhvillim simetrik në plan. Në katin përdhe një holl me lartësi 12 metra lidhet me dy portikate simetrike të cilat të çojnë në dy salla ekspozimi. Planimetria e katin përdhe ka një ndarje të qartë, në të gjithë gjatësinë, të ambienteve të ekspozimit dhe atyre ndihmëse (zyra, laboratorë dhe depo), të vendosura në pjesën e pasme. Nuk kemi praninë e shkallës qendrore në holl, por dy nyje lidhëse vertikale të pozicionuara në skajet e planimetrisë (Fig. 22). Në katin e parë ambientet e ekspozimit komunikojnë nëpërmjet dy portikateve me harqe (Fig. 23, 24).

Në trajtimin volumetrik ndërtesa paraqitet si një volum i madh gjatësor simetrik nga i cili dalin tre volume të tjera më të larta. Përdorimi i portikëve, proporcioni i tyre dhe ritmi i kombinuar i dritareve me arkadat tregojnë interpretimin dhe influencën e arkitekturës vendase dhe demonstrojnë gjuhë të njëjtë arkitektonike me stilin racionalist italian (Fig. 25).

Fasada e thjeshtë, e trajtuar me suva të verdhë në të kuqërremtë, pasurohet nga këto elementë ritmikë si në horizontalitet ashtu dhe në vertikalitet. Hyrja është volumi më i evidentuar i trajtuar me një stil të pastër edhe në interior (Fig. 26).

Volumetria e thjeshtë, proporcioni,

simetria dhe thjeshtësia e materialeve të përdorura karakterizojnë projektin e hartuar nga G. Bertè. Projekti i propozuar nuk arriti të realizohet për arsye se plani urbanistik i 1939-s, hartuar nga G. Bosio, finalizon bulevardin në sheshin Littorio dhe pozicionon në sfondin ballor ndërtesën Casa del Fascio, sot Universiteti Politeknik. Ky projekt mbyll ciklin e propozimeve për të pasur një ndërtesë muzeu të projektuar si e tillë.

## Ripërdorimi i ndërtesave për muze nga 1920 deri 1944

Pamundësia financiare për të ndërtuar godina të reja solli një karakteristikë tjetër të godinave të muzeve shqiptare, përdorimin e ndërtesave me vlera historike dhe arkitektonike për muze. Kjo tendencë është një tipar i arkitekturës së muzeve të pas Luftës së Dytë Botërore në Evropë. Në Shqipëri për arsye të rrethanave ekonomike dhe domosdoshmërisë së ndërtimit të godinave të muzeve, kjo tendencë shfaqet në mesin e viteve '30.

Siç u përmend dhe më sipër historia e ndërtimit të godinave të muzeve në Shqipëri është e lidhur ngushtë me gërmimet arkeologjike. Pasuria arkeologjike e Shqipërisë e zbuluar nga misioni francez dhe italian mund të perceptohej, studiohej dhe të ruhej në kushte normale vetëm nëse do të mundësohej ngritja e godinave të muzeve. Mbështetur në këtë filozofi dy godina të ndërtuara për destinacione të tjera u përdorën si muze.

Ndërtesa ku pati selinë qeveria e Ismail Qemalit, pas disa punimeve të






Fig. 27 Muzeu i parë Arkeologjik, 1936. Planvendosja, planimetri dhe prerje. (Autori)

Fig. 28 Muzeu Arkeologjik i Butrintit, restauruar nga C. Ceschi 1940.



vogla restauruese në 1936, shërbeu si godina e muzeut të parë arkeologjik shqiptar. Sfondi historik i ndërtesës dhe forma e saj kompakte plotësonin kërkesat e një muzeu. Ndërtesa i përket fundit të shekullit XIX dhe u ndërtua si karantinë ushtarake, pjesë e doganës së portit të Vlorës (Fig. 26). Për vetë destinacionin, për të cilin është ndërtuar, godina ka një arkitekturë të thjeshtë me një volum kompakt dy katësh. Në katin përdhe të ndërtesës, në dy salla u ekspozuan skulpturat dhe mbishkrimet, ndërsa në sallat e tjera vazot, figurinat, monedhat, antikitetet me përmasa të vogla.

Propozimet për të përdour si muze ndërtesa me vlera të trashëgimisë historike dhe arkitektonike vinin nga arkeologët e huaj prezent në Shqipëri. Kështu me këmbënguljen e L. M. Ugolinit restaurohet, në 1940, nga Carlo Ceschi fortesa veneciane e Butrintit. Në ambientet e brendshme të saj vendoset dhe muzeu arkeologjik ndërsa në oborrin e kalasë u ekspozuan objekte mermeri si statuja, mbishkrime, etj. Në këto ambiente edhe sot është vendosur muzeu Arkeologjik i Butrintit.

Përpjekjet për të ndërtuar godina të reja dhe për të ripërdour godinat ekzistuese për muze ndërpritet me fillimin e Luftës së Dytë Botërore. Gjatë kësaj periudhe jo vetëm që nuk kemi zhvillime të reja por edhe ato pak godina muzesh u dëmtuan nga lufta, si ndërtesa e muzeut arkeologjik në Vlorë.

## Konkluzione

Tipologjia e ndërtesës së muzeut shqiptar ka fillesat e saja në fundin e shekullit të XIX. Ashtu si të gjithë muzetë evropianë ai u zhvillua në brendësi të ndërtesave të cilat nuk ishin projektuar si muze por kishin tjetër funksion. Fillesat e formësimit të muzeut ndikuan në krijimin e një bërthame fillestare tipologjike të ndërtesës së muzeut publik shqiptar. Muzeu kombëtar i ndërtuar në vitin 1922 reflekton në zgjidhjen e tij planimetrike dhe volumore fillesat e para, arkitekturën dhe stofin urban të kohës. Në fundin e viteve 20-të artefaktet e shumta të zbuluara nga gërmimet arkeologjike thërrisnin domosdoshmërinë e ndërtimit të godinave të muzeve në Shqipëri.

Një kontribut të madh në konsolidimin e tipologjisë së ndërtesës së muzeut shqiptar kanë arkitektët Italianë të viteve 30-të, F. Di Fausto dhe G. Bertè. Ata harmonizuan zhvillimin e tipologjisë së muzeut evropian me situatën urbane të Tiranës (projekti i F. Di Fausto-s) dhe gjithashtu skemave tipologjike të muzeut evropian i veshën elementë të arkitekturës vernakulare të interpretuara në gjuhë shprehëse stilistike (projekti G. Bertè-s, 1938). Zgjidhjet tipologjike merrnin në konsideratë klimën e vendit. Prania e oborrit të brendshëm (projekti i F. Di Fausto-s), ndriçimi dhe ventilimi nga sipër i sallave të muzeut (projekti G. Bertè-s, 1930), portikatet lidhëse janë elementë të studiuar të cilët karakterizuan tipologjinë e ndërtesës së

muzeut deri në fund të Luftës së Dytë Botërore. Edhe pse projektet kryesore të periudhës së trajtuar në këtë artikull mbetën të pa realizuar ato formësuan dhe ndikuan në zhvillimin e mëvonshëm të kësaj tipologjie.

## Literatura

- Adhami, S., (2001). *Muzeologjia Shqiptare*. Tiranë: Gervis
- Aliaj, B., Lulo, K., Myftiu, G. (2003). *Tirana Sfida e Zhvillimit Urban*. Tirana: Co-PLAN/SEDA.
- Gjipali, I. (1998). *Nga muzeu arkeologjik-etnografik tek muzetë e profilizuar arkeologjik*. Iliria. Nr1-2, Tiranë.
- Lewis, G. *The history of museums*. Retrieved 2015, from <http://www.britannica.com>.
- Mengini, A., Pashako, F., Stigliano, M. (2012). *Architettura Moderna Italiana per le citta d'Albania. Modelli e interpretazioni*. Bari: Botimet Dudaj. Collana Archinauti 40.
- Pashako, F. (2014). *I musei archeologici in Albania: storia e criteri di allestimento*. In A. B. Roberta Belli Pasqua, *Ricerche Italiane per il patrimonio archeologico e monumentale dell'Albania*. Bari: Green Advertising.
- Vokshi, A. (2014). *Tracce dell'Architettura Italiana in Albania*. Firenze: DNA Editrice.
- Dokument në Arkivën e Shtetit me Nr. Protokoll 1758/I, 21/X/930
- Dokument në Arkivën e Shtetit me Nr. Protokoll 1758, 6/6/930



# STUDIMI I KAPACITETIT MBAJTËS TË THEMELEVE TË THELLA REALIZUAR ME PILOTA TË GRUPUARA

Diana Lluka<sup>1</sup>, Merita Guri<sup>2</sup>

1.FIN, Fakulteti i Inxhinierisë së Ndertimit, Departamenti i Konstruksioneve dhe Infrastrukturës së Transportit

2.POLIS, Fakulteti i Arkitektures dhe Dizajnit, Departamenti i Arkitekturës dhe Inxhinierisë

Artikulli u recensua nga Prof. Asoc. Diana Haxhihyseni

## Abstrakt:

Objektivi i këtij studimi është llogaritja e kapacitetit mbajtës të themeleve të thella realizuar me grup pilotash bazuar në metoda të ndryshme. Për çdo rast llogaritjeje do të përcaktohet kapaciteti mbajtës duke llogaritur themelet e thella si një grup pilotash të cilat punojnë së bashku ose duke llogaritur kapacitetin mbajtës të grupit si shumë e kontributit të secilës pilotë gjesëmarrëse në grup. Rezultatet do të krahasohen duke vënë në dukje diferencën midis metodave në vlera numerike. Jepen disa rekomandime në përzgjedhjen e vlerës përfundimtare të kapacitetit mbajtës të grupit të pilotave. Gjithashtu do të përcaktohet dhe do të krahasohen në vlera koeficientët e efikasitetit të grupit për çdo metodë të marrë në llogaritje.

## Hyrje

Pilotat rrallë përdoren si elementë të veçuar. Përgjithësisht ato janë të grupuara dhe punojnë së bashku. Kapaciteti mbajtës i grupit të pilotave nuk është i barabartë me kapacitetin mbajtës të një pilote të llogaritur si të veçuar shumëzuar me numurin e pilotave që përmban grupi. Në shumicën e situatave praktike grupi i pilotave është organizuar në struktura të rregullta gjeometrike siç tregohet në Fig. 1. të vendosura në distancën  $s$  (largësia nga qendra e një pilote tek qendra e pilotës fqinje) larg njëra tjetrës jo më të madhe se  $3D$  ( $D$ -diametri i pilotës ose brinja e saj për pilotat me prerje katrore).




Fig. 1. Disa skema të vendosjes planimetricke të grupit të pilotave sipas CRSI, 1992.




Fig. 2. Grupi i pilotave

## Metodat llogaritese të kapacitetit mbajtës të grupit të pilotave

Për distanca aksiale të pilotave, pjesë e grupit, më të vogla se  $3D$ , shpërndarja e sforcimeve në tokë është e tillë që do të shkaktojë mbivendosje ose ndikim në punën e dheut përreth pilotës në shqyrtim të shkaktoar nga pilota më e afërt, gjë që sjell reduktimin e kapacitetit mbajtës të pilotës. Pilotat në një grup janë të lidhura në kokë të tyre me jastëkun lidhës, që mund të jetë ose jo në kontakt me sipërfaqen e truallit të paraqitura në skemat e Fig. 2. Nëse jastëku është direkt në kontakt me truallin ngarkesa do të transferohet direkt në truall edhe përmes jastëkut të pilotave.

Në dherat me strukturë të imët kokrrizore, pilotat periferike priren të mbajnë ngarkesë më të madhe se pilotat pranë qendrës së grupit. Në dherat kokërr trashë, pilotat e pozicionuara në qendër të grupit mbajnë ngarkesë më të madhe se pilotat periferike. Raporti i kapacitetit mbajtës të grupit të pilotave  $(Q_{ult})_{gb}$  me kapacitetin total të pilotave të llogaritur si shumë e kontributit të secilës pilotë pjesëmarrëse në grup sikur pilota të punojë e veçuar shumëzuar me numurin e pilotave  $(n \cdot Q_{ult})$  quhet koeficienti i efikasitetit të grupit,  $\eta_e$ .


$$\eta_e = (Q_{ult})_{gb} / [(Q_{ult})_{bg}^2 + (n \cdot Q_{ult})^2]^{1/2}$$

$n$  është numuri i pilotave në grup dhe  $Q_{ult}$  është kapaciteti mbajtës i një pilote të veçuar. Koeficienti i efikasitetit është gjithmonë një numur më i vogël se 1. Në pilotat në dhera kokërr trasha koeficienti  $\eta_e$  mund të kalojë vlerën 1.

Do të shqyrtohen dy raste të përcaktimit të kapacitetit mbajtës të një grupi pilotash. Forma e parë është quajtur shkatërrim në bllok Fig. 3, mund të ndodhë kur distanca midis akseve të pilotave është  $\leq 3D$  dhe kjo bën që grupi i pilotave të punojë si një i tërë.



Fig. 3. Kapaciteti mbajtës i pilotave grup dhe të veçuara.



Kapaciteti mbajtës i grupit të pilotave do të llogaritet me dy metoda: metoda ESA *effective stress analysis* ose metoda e analizës së sforcimeve efektive dhe metoda TSA *total stress analysis* ose metoda e analizës së sforcimeve totale. Metoda ESA përdoret në të gjitha llojet e dherave ndërsa metoda TSA zakonisht përdoret në dherat kokërr imët.

## A- Metoda TSA

Kjo metodë quhet ndryshe dhe metoda e bazuar në analizën e sforcimeve totale dhe përdoret për llogaritjen e kapacitetit mbajtës të pilotave nën efektin e ngarkesave që veprojnë për një kohë të shkurtër mbi pilotat në dherat kokërr imët. Rezistenca e pilotës llogaritet si shumë e rezistencës anësore të fërkimit dhe-pilotë dhe rezistencës në majë të pilotës që jepet nëpërmjet shprehjes së mëposhtme:

$$(Q_{ult})_{gb} = \sum_{i=1}^j \{(\alpha_u)_i (s_u)_i \times (\text{perimeter})_{igb} \times L_i\} + N_c (s_u)_b (A_b)_{gb}$$

$(Q_{ult})_{gb}$ - është kapaciteti mbajtës i grupit të pilotave

$j$ - është numuri i shtresave gjeologjike brenda gjatësisë së pilotës.

$\alpha_u$  - është koeficienti i aderencës që varet nga lloji i dheut dhe parametri su.

$s_u$  - është vlera e sforcimeve në prerje në troje natyrale.

$g_b$  - është inicial që tregon prezencën e pilotave në grup.

$L_i$  - është gjatësia e pilotës në shtresën  $i$ .

Forca e kohezionit ose e fërkimit pilotë-dhe jepet me shprehjen:

$$Q_f = f_s \cdot (\text{Sipërfaqen anësore te pilotës}) = \sum_{i=1}^j (\alpha_u) \cdot (s_u) (\pi \cdot D) i \cdot L_i$$

Në këtë metodë koeficienti i fërkimit  $f_s$  në sipërfaqen e kontaktit të pilotës me dheun, llogaritet me shprehjen,  $f_s = \alpha_u \cdot s_u$ . Për një pilotë cilindrike me seksion uniform me diametër  $D$  dhe gjatësi  $L$  në dhera homogjene kapaciteti mbajtës nëfërkim është:

$$Q_f = \alpha_u \cdot s_u \cdot \pi \cdot D \cdot L$$

Sipas Randolph Murphy (1985) rekomandohet që për  $f_s$  merret në llogaritje vlera më e vogël nga dy shprehjet e mëposhtme:

$$f_s = 0.5 (s_u \cdot \sigma_{z0})^{0.5} \text{ ose } f_s = 0.5 \cdot s_u^{0.75} (\sigma'_{z0})^{0.25} \text{ ku } \sigma'_{z0} \text{ janë sforcimet efektive vertikale.}$$

Autoret Kolk dhe Van Der Velde (1996), (cited by Rajapakse, R, 2007) propozojne llogaritjen e koeficientit të fërkimit pilote-dhe me shprehjen:  $f_s = 0.55 s_u 0.7(\sigma' z_0) 0.3(40D/L) 0.2$

Referuar American Petroleum Institute (API, 1993) dhe Tomlinson (1987), vlerat e rekomanduara të  $\alpha_u$ , bazuar në matjet në terren jepen në grafikët e mëposhtëm.

Rezistenca në majë e pilotave jepet nga shprehja:  $Q_b = f_b \cdot A_b = N_c(su)_b A_b$

Ku  $f_b$  janë sforcimet kufitare të dheut në bazë,  $N_c$  koeficienti kapacitiv,  $su$  rezistenca në prerje e dheut në zonën midis dy pilotave fqinje dhe  $A_b$  është sipërfaqja e bazës së pilotës.  $N_c$  jepet me shprehjet e mëposhtme:  $N_c = 9$  për  $(su)_b > 25 \text{ kPa}$  dhe  $N_c = 6$  për  $(su)_b \leq 25 \text{ kPa}$

## B- Metoda ESA

Kjo metodë bazohet në llogaritjen e sforcimeve efektive. Përdoret në llogaritjen e kapacitetit mbajtës të pilotave nën efektin e ngarkesave që veprojnë për një kohë të shkurtër dhe për një kohë të gjatë në dherat kokërr trashë dhe për llogaritjen e kapacitetit mbajtës të pilotave nën efektin e ngarkesave që veprojnë për një kohë të gjatë në dherat kokërr imët. Sforcimi efektiv anësor është proporcional me sforcimin vertikal efektiv dhe ky fakt jepet me shprehjen e mëposhtme nepermjet koeficientit  $\beta$ . Kapaciteti mbajtës i pilotës jepet:

$$(Q_{ult})_{gb} = \sum_{i=1}^j \{ \beta_i (\sigma'_z)_i \times (\text{perimeter})_{igb} \times L_i \} + N_q (\sigma'_z)_b (A_b)_{gb}$$

$(Q_{ult})_{gb}$  - është kapaciteti mbajtës i grupit të pilotave

$g_b$  - është inicial që tregon prezencën e pilotave në grup.

$L_i$  - është gjatësia e pilotës në shtresën  $i$ .

$j$  - është numuri i shtresave gjeologjike brenda gjatësisë së pilotës.

$\sigma'_z$  - është vlera e sforcimeve vertikale.

$\beta_i$  - mund të llogaritet:

a) Për dherat kokërr trasha sipas Burland (1973)

$$\beta = K \tan \phi_i' = (1 - \sin \phi_{cs}') (OCR)^{0.5} \tan \phi_i'$$

Ku OCR është shkalla e mbikonsolidimit,  $\phi_i'$  është këndi i fërkimit të brendshëm të dheut dhe  $\phi_{cs}'$  është vlera kufitare e fërkimit të brendshëm dhe varet nga karakteristikat e dheut.

b) Për rërën sipas Burland (1973)

$$\beta = K \tan \phi_i' = (1 - \sin \phi_{cs}') \tan \phi_i'$$

c) Për rërë gëlqerore të paçimentuar sipas Poulos (1988),  $\beta = 0.05 - 0.1$

$A_b$  - është sipërfaqja e bazës e grupit të pilotave.

Rezistenca në majë jepet nga shprehja  $Q_b = f_b \cdot A_b = N_q (\sigma'_z)_b A_b$

Ku  $f_b = N_q (\sigma'_z)_b$  janë sforcimet kufitare të dheut në bazë,  $N_q$  është koeficienti kapacitiv funksion i  $\phi'$ , dhe  $(\sigma'_z)_b$  janë sforcimet efektive në bazë dhe  $A_b$  është sipërfaqja e bazës së pilotës. Llogaritja e koeficientit kapacitiv  $N_q$  bëhet nëpërmjet grafikëve të Fig. 5.



## G- Metoda e llogaritjes së kapacitetit mbajtës të grupit të pilotave si shumë të kapacitetit mbajtës të pilotave të veçuara.

Një mënyrë tjetër llogaritjeje është supozimi i punës së pavarur të secilës pilotë pjesë e grupit. Referuar kësaj hipoteze mund të kemi shkatërim të pilotave të veçuara paraprakisht që shoqërohet me uljen e kapacitetit mbajtës të grupit të pilotave, që sjell më pas shkatërrimin e gjithë grupit. çdo pilotë konsiderohet se arrin në mënyrë të pavarur nga të tjerat pjesë të grupit kapaciten e plotë mbajtës të saj. Duke shënuar  $n$  numrin e pilotave pjesë të grupit kapaciteti mbajtës i grupit është :

$$(Q_{ult})_{gb} = nQ_{ult}$$


$(Q_{ult})$  është kapaciteti mbajtës i një pilote të veçuar

Koeficienti i efikasitetit të kapacitetit mbajtës të grupit të pilotave llogaritet:

$$\eta = (Q_{ult})_{gb} / \sqrt{[(Q_{ult})_{gb}^2 + Q_{ult}^2]}$$

Përgjithësisht, forma e shkatërrimit të pilotave të veçuara ndodh për pilotat e realizuara në rëra kur distanca midis akseve të pilotave në grupin e pilotave është më e madhe se

Fig. 4. Varësia e koeficientit të aderencës  $\alpha$  me sforcimet në prerje  $s_u$  sipas Tomlison, 1987.



3D. Shkaku kryesor është se rëra midis pilotave fqinje bëhet një zone kompakte, që sjell si pasojë rritjen e fërkimit të dheut me piloten në sipërfaqen anësore të pilotës për çdo pilotë individuale. Në rastin e pilotave në rëra homogjene duket të predominojë forma e shkatërrimit bllok sepse fërkimi anësor në pilotat individuale reduktohet brenda grupit për shkak të mbivendosjes sezonës së prerë. Në praktikë ngarkesa kapacitive është shumë e rezistences nëfërkim të pilotës me kapacitetin mbajtës në majë. Koeficienti i sigurisë zakonisht merr vlerat nga 2-5, por më e përdorshme është 2-3.




Fig. 5. Krahasimi i vlerave të koeficientit kapacitiv  $N_q$  në majë të pilotës sipas autorëve.

Sipas paraqitjes së Fig. 4 gjendja e sforcuar e dheut nuk është uniforme. për dherat kokërr trasha ka një shpërndarje pothuajse lineare duke u zvogëluar me rritjen e thellësisë. Ndërsa për dherat imta vërehet një shpërndarje jo lineare. Në të dy rastet vlerat maksimale janë afër sipërfaqes e zvogëlohen me rritjen e thellësisë por janë në varësi të llojit të dheut. Provat në terren kanë treguar se të mund të arrihet të mobilizohet fërkimi në faqet anësore të pilotës është e nevojshme një zhvendosje vertikale e pilotës me 2.5-10mm. Zhvendosja vertikale varet nga lloji i dheut dhe është e pavarur nga diametri dhe gjatësia e pilotës. Rezistenca në majë mobilizohet në pilotat e ngulura me goditje kur zhvendosja vertikale është rreth 8%-10% e diametrit të pilotës ndërsa për pilotat e derdhura zhvendosja vertikale duhet të shkojë deri në 30% e diametrit të pilotës. Sipas Fig. 6. rezistenca në majë është e ngjashme me skemën e punës së themeleve të cekët. Koeficienti i kapacitetit të pilotës është  $N_q$ .

### Shembull: Llogaritja e kapacitetit mbajtës të grupit të pilotave.

Një grup prej 9 pilotash të ngulura prej betoni të armuar me diametër 0.45m dhe gjatësi 10m janë vendosur si në planimetrinë e paraqitur në distancë aksiale qendrore 1.2m. Shtresa e parë e truallit është argjilë mesatarisht e ngjeshur deri në thellësinë 8m, ku sforcimet në prerje në troje natyrale janë  $s_u=20\text{kN/m}^2$ , këndi i fërkimit të brendshëm  $\varphi'_{cs}=30^\circ$ , peshat volumore  $\gamma=17\text{kN/m}^3$  dhe  $\gamma_{sat}=18\text{kN/m}^3$ , shkalla e mbikonsolidimit  $\text{OCR}=2$ . Shtresa e dyte është argjilë e ngjeshur me parametra  $s_u=86\text{kN/m}^2$ ,  $\varphi'_{cs}=28^\circ$ ,  $\gamma=17\text{kN/m}^3$ ,  $\gamma_{sat}=18.5$ ,  $\text{OCR}=5\text{kN/m}^3$ .

Do të llogaritet kapaciteti mbajtës në ngarkesë vertikale e grupit të pilotave me koeficient sigurie  $F_s=2$ . Niveli i ujrave nëntokesore është 2m nën nivelin e tokës natyrale por mund të ngrihet deri në sipërfaqe në periudhat e lagështa. Jastëku nuk është në kontakt me truallin.







Fig. 6. Mënyra e transferimit të ngarkesës në truall



Llogaritja e kapacitetit mbajtës të grupit të pilotave do të bëhet në dy raste. Do të llogaritet kapaciteti mbajtës i grupit të pilotave kur punon si një bllok i tërë (1) dhe do të llogaritet kapaciteti mbajtës i një pilete të veçantë e më pas do të llogaritet kapaciteti mbajtës total i grupit të pilotave si shumë e kontributit të secilës pilete pjesëmarrëse në grup (2). Do të përdoren metoda llogaritëse TSA (Total stress analysis), ESA (Effective stress analysis), për përcaktimin e kapacitetit mbajtës të grupit të pilotave për të dy rastet në shqyrtim, do të përcaktohet koeficienti i efikasitetit të grupit dhe më pas rezultatet do të krahasohen.

### Llogaritja e parametrevave geometrike.

- Për pilotën e veçuar: Diametri i pilotës është  $D=0.45\text{m}$ , perimetri  $P_b=\pi D=1.413\text{m}$  dhe sipërfaqja e prerjes tërthore të pilotës është  $A_b=\pi D^2/4=0.159\text{m}^2$ .

Për grupin e pilotave: Perimetri  $P_{bg}=4 \cdot 2.85=11.4\text{m}$ , sipërfaqja e bazës  $A_{bg}=2.85^2=8.1225\text{m}^2$ . Supozojmë se niveli i ujrave nëntokesore është deri në sipërfaqe të truallit.

Për shtresën e parë të argjilës mesatarisht të ngjeshur:  $\gamma'=\gamma_{\text{sat}}-\gamma_e=18-9.8=8.2\text{ kN/m}^3$ , ku  $\gamma_e$  është pesha volumore e ujit. Sforcimet në mes të shtresës së parë quhen sforcimet efektive vertikale:  $\sigma_{z01}'=\gamma' \cdot h_{\text{shtre}}/2=8.2 \cdot 8/2=32.8\text{ kN/m}^2$ .

Llogarisim koeficientin e fërkimit dhe-pilotë fs. Sipas metodës Randolph-Murphy (1985) rekomandohet të merret vlera më e vogël midis:

$$f_{s1} = 0.5\sqrt{s_u \cdot \sigma_{z01}'} \rightarrow f_{s1} = 0.5\sqrt{20 \cdot 32.8} = 12.81\text{ kN/m}^2$$

$$f_{s1} = 0.5s_u^{0.75}(\sigma_{z01}')^{0.25} = 0.5 \cdot 20^{0.75} \cdot 32.8^{0.25} = 11.31\text{ kN/m}^2$$

Zgjidhet  $f_{s1}=11.31\text{ kN/m}^2$  si vlera më e vogël e rekomanduar.

$$\beta_1=(1-\sin\phi_{cs}')\text{tg}\phi_{cs}'=(1-\sin 30^\circ)=0.41$$

Për shtresën e dytë të argjilës së ngjeshur:  $\gamma'=\gamma_{\text{sat}}-\gamma_e=18.5-9.8=8.7\text{ kN/m}^3$ . Sforcimet në mes të shtresës së dytë ose sforcimet efektive vertikale janë:

$$\sigma_{z02}'=\gamma' \cdot h_{\text{shtre}}/2=8.2 \cdot 8+8.7 \cdot 2/2=74.3\text{ kN/m}^2$$

Llogarisim koeficientin e fërkimit dhe-pilotë fs. Sipas metodës Randolph-Murphy (1985) rekomandohet të merret vlera më e vogël midis:

$$f_{s2} = 0.5\sqrt{s_u \cdot \sigma_{z02}'} = f_{s2} = 0.5\sqrt{86 \cdot 74.3} = 39.97\text{ kN/m}^2$$

$$f_{s2} = 0.5s_u^{0.75}(\sigma_{z02}')^{0.25} = 0.5 \cdot 86^{0.75} \cdot 74.3^{0.25} = 41.46\text{ kN/m}^2$$

Zgjidhet  $f_{s2}=39.97\text{ kN/m}^2$  si vlera më e vogël e rekomanduar.

$$\beta_2=(1-\sin\phi_{cs}')\text{tg}\phi_{cs}'=(1-\sin 28^\circ)=0.63$$

### Llogaritja e kapacitetit mbajtës me metodën TSA:

Llogarisim kapacitetin mbajtës të bllokut të pilotave:  $Q_{fi}=f_{si} \cdot P_{bg} \cdot l_i$

$$Q_{f1}=11.31 \cdot 11.4 \cdot 8=1031.5\text{ kN (shtresa 1)}, Q_{f2}=39.97 \cdot 11.4 \cdot 2=911.32\text{ kN (shtresa 2)}$$

Aftësia mbajtëse në majë të pilotës:  $Q_{p2}=s_u \cdot A_{bg}=86 \cdot 8.1225=6976.5\text{ kN (shtresa 2)}$

Aftësia mbajtëse totale e pilotës është:

$$(Q_{ult})_{gb}=[Q_{f1}+Q_{f2}+Q_{p2}]/F_s=[1031.5+911.32+6976.5]/2=4459.66\text{ kN}$$

Llogarisim kapacitetin mbajtës të pilotave të veçuara:

$$Q_{f1}' = Q_{f1} \cdot P_b / P_{bg} = 1031.5 \cdot 1.413 / 11.4 = 127.85 \text{ kN (shtresa 1)}$$

$$Q_{f2}' = Q_{f2} \cdot P_b / P_{bg} = 911.32 \cdot 1.413 / 11.4 = 112.96 \text{ kN (shtresa 2)}$$

$$Q_{p2}' = Q_{p2} \cdot A_b / A_{bg} = 6976.5 \cdot 0.159 / 8.1225 = 136.56 \text{ kN (shtresa 2)}$$

$$Q'(\text{pilotës së veçuar}) = Q_{f1}' + Q_{f2}' + Q_{p2}' = 127.85 + 112.96 + 136.56 = 377.37 \text{ kN}$$

Për llogaritjen e aftësisë mbajtëse të bllokut të pilotave duke marrë në konsideratë punën e pavarur të secilës pilotë pjesë e grupit:  $Q_{ult}' = n \cdot Q'(\text{pilotës së veçuar}) / F_s = 9 \cdot 377.37 / 2 = 1698.165 \text{ kN}$

Koeficienti i efikasitetit të grupit është:

$$\eta = (Q_{ult})_{gb} / \sqrt{[(Q_{ult})_{gb}^2 + Q_{ult}'^2]} = 4459.66 / \sqrt{[(4459.66)^2 + 1698.16^2]} = 0.68$$

### Llogaritja e kapacitetit mbajtës me metodën ESA:

**1. Llogarisim kapacitetin mbajtës të grupit të pilotave:**  $Q_{fi} = \beta_i \cdot \sigma_{z0i}' \cdot P_{bg} \cdot l_i$

$$Q_{f1} = 0.41 \cdot 32.8 \cdot 11.4 \cdot 8 = 1226.46 \text{ kN (shtresa 1)}, Q_{f2} = 0.63 \cdot 74.3 \cdot 11.4 \cdot 2 = 1067.25 \text{ kN (shtresa 2)}$$

Aftësia mbajtëse në majë të pilotës është:  $Q_{p2} = N_q (\sigma_z') \cdot b \cdot A_{bg}$  (shtresa 2)

$$N_q = 0.6 \cdot \exp(0.126 \cdot \phi'_{cs}) = 0.6 \cdot \exp(0.126 \cdot 28) = 20.4 \text{ (Janbu 1976)}$$

Sforcimet në majë të pilotës janë:  $(\sigma_z') \cdot b = \gamma_1' \cdot 11 + \gamma_2' \cdot 12 = 8.2 \cdot 8 + 8.7 \cdot 2 = 83 \text{ kN/m}^2$  dhe

$Q_{p2} = 20.4 \cdot 83 \cdot 8.1225 = 13753 \text{ kN}$ . Aftësia mbajtëse totale e grupit të pilotave është:

$$(Q_{ult})_{gb} = [Q_{f1} + Q_{f2} + Q_{p2}] / F_s = [1226.46 + 1067.25 + 13753] / 2 = 8023.36 \text{ kN}$$

**2. Llogarisim kapacitetin mbajtës të pilotave të veçuara:**

$$Q_{f1}' = Q_{f1} \cdot P_b / P_{bg} = 1226.46 \cdot 1.413 / 11.4 = 152 \text{ kN (shtresa 1)}$$

$$Q_{f2}' = Q_{f2} \cdot P_b / P_{bg} = 1067.25 \cdot 1.413 / 11.4 = 132.3 \text{ kN (shtresa 2)}$$

$$Q_{p2}' = Q_{p2} \cdot A_b / A_{bg} = 13753 \cdot 0.159 / 8.1225 = 269.2 \text{ kN (shtresa 2)}$$

$$Q'(\text{pilotës së veçuar}) = Q_{f1}' + Q_{f2}' + Q_{p2}' = 152 + 132.3 + 269.2 = 553.5 \text{ kN}$$

Për llogaritjen e aftësisë mbajtëse të bllokut të pilotave duke marrë në konsideratë punën e pavarur të secilës pilotë:  $Q_{ult}' = n \cdot Q'(\text{pilotës së veçuar}) / F_s = 9 \cdot 553.5 / 2 = 2490.75 \text{ kN}$

Koeficienti i efikasitetit të grupit është:

$$\eta = (Q_{ult})_{gb} / 8023.36 = 0.95$$

### Sipas Donald P. Coduto (2001):

**1. Llogaritja e kapacitetit mbajtës të grupit të pilotave në argjila :**

$$Q_{ult} = \Sigma [2 \cdot D \cdot (B_g + L_g) s_{ui}] + B_g \cdot L_g \cdot s_{u2} \cdot N_c^* / F_s$$

$$N_c^* = 5(1 + D / (5B_g))(1 + B_g / (5L_g)) = 5[1 + 10 / (5 \cdot 2.85)][1 + 2.85 / (5 \cdot 2.85)] = 10.21$$

Por për  $N_c^* \leq 9$  pranojmë  $N_c^* = 9$ .

$$Q_{ult} = \{ [2 \cdot 8 \cdot (2.85 + 2.85) \cdot 20] + [2 \cdot 2 \cdot (2.85 + 2.85) \cdot 86] + 2.85 \cdot 2.85 \cdot 86 \cdot 9 \} / 2 = 5035.8 \text{ kN}$$

$B_g$ -brinja më e vogël e grupit të pilotave;  $L_g$ -brinja më e madhe e grupit të pilotave;

$D$ -thellësia e nguljes së pilotave;  $N_c^*$ -koeficienti i kapacitiv.



## 2.Llogarisim kapacitetin mbajtës të pilotave të veçuara sipas metodës ESA:

$$Q_{f1}' = 152 \text{ kN (shtresa 1)}$$

$$Q_{f2}' = 132.3 \text{ kN (shtresa 2)}$$

$$Q_{p2}' = 269.2 \text{ kN (shtresa 2)}$$

$$Q'(\text{pilotës së veçuar}) = Q_{f1}' + Q_{f2}' + Q_{p2}' = 152 + 132.3 + 269.2 = 553.5 \text{ kN}$$

### Sipas D.P.Coduto (2001) referuar Converse-Labarre (1941) koeficienti i efikasitetit

$\eta = 1 - \theta[(n-1)m + (m-1)n] / (90 \cdot m \cdot n)$  ku m-numuri i rreshtave të pilotave; n- numuri i pilotave në një rresht; B- diametri i pilotës; s- distanca midis qendrave të pilotave,  $\theta = (B/s)$ ;

$$\theta = (0.45/1.2) = 20.55 \text{ dhe } \eta = 1 - 20.55[(3-1)3 + 3(3-1)] / (90 \cdot 3 \cdot 3) = 0.69$$

Sipas D.P.Coduto(2001) koeficienti i efikasitetit mund të llogaritet edhe me formulën:

$$\eta = [2s(m+n) + 4B] / (\pi \cdot m \cdot n \cdot B) \leq 1 \text{ ku } \eta = [2 \cdot 1.2(3+3) + 4 \cdot 0.45] / (\pi \cdot 3 \cdot 3 \cdot 0.45) = 1.27 \text{ por nëse}$$

$\eta > 1$  pranohet  $\eta = 1$ . Duke pranuar në llogaritje  $\eta = 0.69$  sipas Converse-Labarre (1941):

$$(Q_{ult})_{gb} = \eta \cdot n \cdot Q' = 0.69 \cdot 9 \cdot 553.5 = 3437.235 \text{ kN}$$

Duke krahasuar koeficientet e efikasitetit të grupit vërejmë :

	TSA	ESA	Converse-Labarre	D.P.Coduto
$\eta$	0.68	0.95	0.69	1

Krahasojmë në mënyrë tabelare kapacitetet mbajtëse të grupit të pilotave të llogaritura më lart:

METODA	BLLOK PILOTASH [KN]	PILOTE E VEÇUAR [KN]
TSA (Total stress analysis)	4459.66	1698.165
ESA (Effective stress analysis)	8023.36	2490.75
D. Coduto	5035.8	3437.235

## Konkluzione

- Një grup pilotash të lidhura me jastëk mund të shkatërohen si një njësi e vetme ose shkatërimi mund të vijë si rezultat i shkatërimit të pilotave të veçuara pjesë e grupit.
